



KRITERI I NOTËS MESATARE “SUKSES I SHKËLQYESHËM” NDIKON NË VLERËSIMIN JOETIK SË TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE NË SHKOLLA FILLORE

Merita Banjicaⁱ

Dr.,

Faculty of Languages, Cultures and Communication,

South East European University (SEEU),

Tetovo, North Macedonia

Abstrakt:

Vlerësimi profesional i të arriturave të nxënësve mbështetet në vlerësimin etik dhe objektiv të së arriturave të nxënësve, prandaj mësimdhënësit e shekullit XXI u trajnuan për t'i zbatuar rritë e vlerësimit gjatë procesit të mësimdhënies, që të ndikojnë në përmirësimin e të arriturave të tyre. Në shkollat e Maqedonisë së Veriut vlerësimi është transparent, ku çdo prind mund të marrë informatë për arritjet e fëmijës së vet nga e-ditari, ndërsa për prindërit, që nuk janë në gjendje t'i përdorin teknologjitë e informacionit përgatiten fleta evidentuese me shkrim. Transparenca e notave në e-ditar mundëson çdo prind t'i shoh notat e fëmijës, por edhe e orienton t'i drejtohet mësimdhënësit të lëndës për t'ia përmirësuar notën fëmijës, që suksesi i tij të jetë i shkëlqyeshëm për t'u regjistruar në shkollë të mesme. Mësimdhënësit gati çdo vit si në gjysmëvjetorin e parë, ashtu edhe në fund të vitit shkollor përballen me shumë presione për përmirësimin e notave të disa nxënësve nga shumë subjekte si prind, kolegë, drejtor, miq etj., ashtu që në fund reflektohet vlerësimi sumativ joobjektiv dhe joetikë. Ky hulumtim kishte për qëllim të zbulojë shkakun e vlerësimit joobjektiv dhe joetikë, prandaj në bazë të teorive shkencore të shqyrtuara për vlerësimin u përgatitën pyetësorë për prindër, mësimdhënëse, nxënës. Hulumtimi u zhvillua në Shkollën Filllore “Ismail Qemali”-Gostivar në Republikën e Maqedonisë së Veriut më 23-29 janar 2023. Anketimi u zhvillua me 56 nxënës të klasave të shtata, me 56 prind të atyre nxënësve dhe 14 mësimdhënëse, që ligjërojnë në ato klasa. Gjithsej u anketuan 126 individ. Mostra e këtij hulumtimi ishte e rastësishme, por e qëllimshme. Hulumtimi u përqendrua katër objektiva:

- Të zbulojë opinionin e nxënësve për vlerësimin objektiv të të arriturave të tyre.
- Të zbulojë opinionin e mësimdhënësve për vlerësimin objektiv të të arriturave të nxënësve.

ⁱ Correspondence: email meritabanjica@yahoo.com

- Të zbulojë opinionin e prindërve për vlerësimin objektiv të së arriturave të fëmijëve të tyre.
- Të zbulojë faktorët që ndikojnë për mosrealizimin e vlerësimit objektiv.

Fjalët kyçe: vlerësimi profesional, vlerësimi objektiv, vlerësimi etikë

1. Shqyrtime Teorike Për Vlerësimin

1.1 Hyrje

Në këtë punim ofrohen sqarime teorike për vlerësimin etik profesional së të arriturave të nxënësve në shkolla fillore, që mbështetet në vlerësime formative dhe sumative për çdo periudhë mësimore tremujore, ku reflektohen me nota arritjet e tyre.

Vlerësimi etik profesional i të arriturave të nxënësve realizohet nga mësimpldhënësi, i cili vepron sipas aftësive vlerësuese me reflektimin e vlerave demokratike etike për vlerësim objektiv, reflekton shkathtësi vlerësuese (përgatitje të instrumenteve vlerësuese sipas përmbushjes së kriterëve), përdor etikën në vlerësim (nuk ndikohet nga asnjë subjekt tjetër në formulimin e notës përmbyllëse), por mbështetet në vlerësim objektiv formativ të arritjeve të çdo nxënësi.

Në pjesën empirike pasqyrohen rezultatet e reflektuara në pyetësorët për mësimpldhënësin, nxënësin dhe prindër. Në pjesën përfundimtare formulohen përfundimet dhe jepen rekomandimet.

1.2 Vlerësimi profesional i të arriturave të nxënësve

Vlerësimi është pjesë e pandarë e procesit mësimor, prandaj gjatë çdo ore mësimore çdo mësimpldhënësi e vëzhgon pjesëmarrjen aktive të çdo nxënësi në çdo aktivitet mësimor për të krijuar bindje se nxënësi mëson, por ai mbështetet edhe në rezultatet e notave të reflektuara në instrumentet vlerësuese formative, për edhe në reflektimin e qëndrimit të çdo nxënësi për vlerësimin e bërë. Formulimin e notës përmbyllëse (vlerësimi sumativ) i bazuar në vlerësimet formative të disa nxënës ka efekt motivues, kurse të disa ka efekt demotivues për të mësuarit.

Vlerësimi në shkollë fillore realizohet sipas dokumentit të parë të përgatitur nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit në Sektorin për Vlerësimin e të Arriturave të Nxënësve, ku janë përcaktuar standardet e vlerësimit të nxënësve për shkollën fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vlerësim intern të së arriturave të nxënësve, por edhe për vlerësim ekstern mund të përdoren.

Standardet janë bazuar në parimet e vlerësimit cilësorë dhe korrekt, që janë pjesë përbërëse e standardeve dhe janë përcaktuar në pesë faza:

- Planifikimi i vlerësimit,
- Zgjedhja e metodave dhe përpunimi i instrumenteve,
- Zbatimi i procesit të vlerësimit,
- Formimi i notës,
- Informimi për arritjet e vlerësimit.

Vlerat demokratike në arsim reflektohen me respektimin e parimeve të: drejtësisë, paanshmërisë, objektivitetit, barazisë, mosdiskriminimit, integritetit, transparencës, përgjegjshmërisë, llogaridhënies, bashkëpunimit të tjerë, efikasitetit të burimeve, neutralitetit politik, veshjes etike, zhvillimit permanent profesional, humanitetit, sjelljes etike në punë dhe në publik. Të gjithë palët e interesuar për vlerësim etik duhet t'i zbatojnë këto parime në çdo institucion arsimor.

1.2.1 Llojet e vlerësimeve

Vlerësimi bëhet nga mësimdhënësi për të matur arritjet e dijeve të nxënësit, për të konstatuar përparimin e nxënësit në të mësuarit dhe për ta konstatuar rezultatin e mësimdhënies së vet, t'i përcaktojë strategjitë mësimore, që duhet t'i përdor në të ardhmen (metoda, instrumente vlerësuese dhe forma mësimore). Vlerësimi i të arriturave të nxënësve mund të jetë tri llojesh:

A. Vlerësimi formativ

Vlerësimi formativ (formues) është proces i matjes së të arriturave të nxënësve me instrumente të ndryshme vlerësuese gjatë procesit të mësimdhënies, që përdoren për të nxitur dhe përkrahur nxënësin në zhvillimin mendor të tij për të dhënë përgjigje kthyesë në procesin ligjërues/mësimor. Gjatë çdo ore mësimore nga mësimdhënësi bëhet vëzhgim permanent i angazhimit të çdo nxënësi në aktivitete mësimore, reflektimi i sjelljes dhe reflektimi i qëndrimit të tyre për përvetësimin e mësimit me informatë kthyesë gojore ose me shkrim.

Vlerësimi formativ me informatën kthyesë (feedback) nxënësve u ndihmon:

- të zbulojnë sesa të suksesshëm ose të mossuksesshëm janë në të mësuarit e tyre për ta përqendruar të mësuarit në fushën e duhur për të arritur sukses dhe përparim.
- të zbulojnë se në cilën fushë nxënësit kanë problem me të mësuarit për të bërë sqarime dhe aktivitete shtesë, atje ku nxënësit reflektojnë dobësi ose jokuftueshmëri.

Vlerësimi formativ mund të jetë:

- Notim formativ joformal i vazhdueshëm (diagnostik) është planifikuar nga mësimdhënësi për të nxitur dhe përparuar të mësuarit e nxënësit duke i dhënë atij udhëzime në formë të vetëvlerësimit dhe vlerësimit nga mësimdhënësi. Ky vlerësim bëhet edhe orientues për planifikimin e mësimdhënies, për përcaktimin strategjive mësimore për notim, që të përdoren nga të gjithë.
- Vlerësimi formativ formal i vazhdueshëm është përdorim i shumë mënyrave, instrumenteve dhe formave për demonstrimin e shkathtësive në një varg kontekstesh, ku përdoren matje të arritjeve të dijeve të çdo nxënësi në aktivitete të ndryshme si shpërblime me notë ose me shenjë, që përfshihen te vlerësimi përmbledhës.

B. Vlerësimi përmbledhës (sumativ)

Vlerësimi përmbledhës (sumativ) është vlerësim për cilësinë ose vlerën e arritjes së nxënësit pas kryerjes të një pjese të procesit mësimor, që është më i dobishëm në kuptimin e planifikimit të aktiviteteve të përditshme se sa vlerësimi formativ. Qëllimi i vlerësimit përmbledhës është matja e arritjeve të nxënësve në fund të zhvillimit të një teme mësimore:

- Lista evidentuese (informimi i nxënësve, prindërve dhe subjekteve në shkollë).
- Identifikimi i nxënësve për mësim shtues dhe plotësues.
- Matja e punës mësimore të mësimdhënësit (vlerësimi i orëve si të suksesshme ose të pasuksesshme dhe identifikimi i strategjive mësimore për në vijim). (Figura 1).

C. Vlerësimi ipsativ

Vlerësimi ipsativ është vlerësimi i drejtuar nga vetvetja, që e nxit çdo nxënës vet t'i krahasojë të arriturat e veta me prapaket sesa t'i krahasojë me të arriturat e nxënësve tjerë.

- Vlerësimi me kritere, ku standardet e realizimit janë të përcaktuara qartë.
- Informata kthyesë me orintim të qëllimshëm, sqarime të qarta për të mësuarit
- Përfshirja aktive e nxënësve në vetënotim.
- Dhënia e një zgjedhjeje të caktuar nxënësve për mënyrën e veprimit drejt arritjes së zgjidhjes së detyrave mësimore. (sqarim në Figurën 1)




Figura 1: Vlerësimi, llojet e vlerësimit (formativ, sumativ dhe ipsativ) dhe qëllimet e vlerësimit

Tabela 1: Klasifikimi i vlerësimit dhe instrumentet vlerësuese për lëndën e gjuhës shqipe

Vlerësimi			
Vlerësimi formativ (formues)		Vlerësim përmblledhës (sumativ)	Vlerësim nga vetvetja (ipsativ)
Vlerësim formativ më pak formal	Vlerësim formativ më formal	Vlerësim me teste të standardizuara	
Organizues grafik “stuhi mendimesh” dhe reflektimi i mendimeve për plotësimin e organizuesit grafik. Lexim të rrjedhshëm të teksteve Lexim artistik të poezive Ritregim i teksteve Portretizim të personazheve Formulim i fjalive për tërësitë logjike Të shprehurit në gjuhën letrare Prezantime të projekteve Simulime të roleve Punim të ushtrimeve gramatikore Analiza e fjalive dhe fjalëve Analiza e figurave stilistike Analiza metrike poezive etj. Leximi i lektyrave	Portfolio të instrumenteve vlerësuese: Ese (krijime me shkrim me strukturë të përcaktuar si raporte, ftesa, ankesa, kërkesa, lutje, ese përshkruese, ese argumentuese-bindëse, ese treguese për një temë të caktuar etj.) Krijime me shkrim të temave klasike, Fletëza për klasifikime e pjesëve të ligjëratës Fletëza për klasifikimin e gjymtyrëve të fjalive etj. Çek lista për të mësuarit Projekte etj.	Teste praktike Test në tremujorinë e parë Test në para gjysmëvjetorit. Teste në tremujorin e tretë. Teste në fund të vitit. Hartime –krijimtaria Hartimi I- gjysmëvjetori i parë, Hartimi II- gjysmëvjetori i dytë Hartimi III- gjysmëvjetori i dytë. Lista evidentuese të arriturave të nxënësve- dokument Lista e nxënësve për mësim shtues dhe plotësues Matja e punës mësimore të mësimdhënësit si e suksesshme ose e pasuksesshme.	Vlerësimi me kritere, ku standardet e realizimit janë të përcaktuara qartë. Informata kthyesë të qëllimshme të orientuara, sqarime të qarta se si drejtojmë të mësuarit. Përfshirja aktive e nxënësve në vetënotim Dhënia e një zgjedhjeje të caktuar nxënësve për mënyrën e veprimit drejt arritjes së zgjidhjes së detyrave mësimore

1.3 Vlerësimi objektiv

Vlerësimi objektiv cilësorë është në varësi nga profesionalizmi i mësimdhënësit: sjellja, aftësitë vlerësuese, shkathhtësitë për përgatitjen e instrumenteve vlerësuese, por është edhe në varësi edhe nga zhvillimi dimensional moral i tij.

Vlerësimi formativ cilësorë është aktivitetet profesional, human dhe moral i mësimdhënësit, ku rezultatet e vlerësimit përdoren për të ndikuar pozitivisht të nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit. Vlerësimi nëse nuk është i drejtë dhe i saktë mund ta lëndojë edhe personalitetin e çdo nxënësi, ta emocionojë dhe demotivojë për të mësuarit në vazhdimësi, prandaj vlerësimi objektiv mbështetet në katër karakteristikat themelore të vlerësimit. (Lin R.L dhe Miller M.D. 2005 shih: Zbatimi i standardeve të notimit të nxënësve 2008:8, Shkup).

A. Vlefshmëria

Vlefshmëria është masë adekuate dhe përkatëse e interpretimit dhe përdorimit të rezultateve të vlerësimit. Informata për vlefshmërinë mund të merren bashkë me ndonjë instrument vlerësimi. Vlefshmëria dhe besueshmëria janë karakteristikat themelore të vlerësimit.ⁱⁱ

Njihën katër lloje të vlefshmërisë, që mbështeten në instrumente të vlerësimit:

- Instrumente të vlefshmërisë përmbajtësore (test të standardizuar + pyetësor).
- Instrumente të vlefshmërisë të konstruktit (qëllimi mësimor-pyetjet e testit-përgjigjet e nxënësve-rezultatet) p.sh. përdorimi i gjuhës dhe drejtshkrimit në tekstin e testit, etj.
- Instrumente të vlefshmërisë së vlerësimit në orë kanë efekt mbi të arriturat dhe motivimin e nxënësve, që duhet t'i ndjekin arsimtarët dhe nxënësit si:
 - a) pasoja pozitive (rritje të motivimit, përpjekjes dhe përkushtimit për mësim.
 - b) pasojat negative (nëse testi mat vetëm shkathtësitë në mësim, ndërsa i len anësh aspektet tjera atëherë zvogëlohet interesi i nxënësit, motivimi, që mund ta shtyjë nxënësin të largohet nga shkolla). Kjo ndodh nëse vlerësimi nuk është i qëlluar për aftësitë e një grupit të caktuar ose detyrat vijojnë sipas një skene të njëjtë.
- Instrumente të vlefshmërisë së lidhjes në mes rezultateve të testit dhe kriterit. Korrelacioni në mes të një testi të drejtshkrimit dhe një testi me shkrim, krahasimi i rezultateve të vlerësimit.

B. Besueshmëria

Besueshmëria arrihet nëse nxënësi tregon rezultate të njëjta në disa instrumente vlerësuese, (teste të ndryshme, në vazhdimësi kryerjen e detyrave të shtëpisë, në reflektimin e disa niveleve të aftësive mendore gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme dhe nëse vlerësimi bëhet nga dy notues të ndryshme në të njëjtin instrument vlerësues).

C. Siguria

Siguria dhe verifikimi është lidhje e fuqishme në mes besueshmërisë dhe vlefshmërisë. Siguria ka të bëjë me një marrëdhënie të baraspeshuar ndërmjet besueshmërisë dhe vlefshmërisë. Një notim mund të përshkruhet si i sigurt nëse është i vlefshëm dhe i besueshëm.

D. Zbatueshmëria

Zbatueshmëria e testit dhe vlerësimit duhet të jetë i zbatueshëm në kufizime relative kohore, por relative mund të jenë edhe kërkesat e mësimdhënësve në lidhje me dhënien e pikëve. Një notim mund të jetë i pazbatueshëm, për shkak të një ose më shumë shkaqeve:

ⁱⁱ Zbatimi i standardeve të notimit të nxënësve 2008:8, Shkup

- Kërkesat ndaj mësimdhënësit janë të shumta (shumë detyra, që duhet t'u jepen nxënësve).
- Fletët e vlerësimit analitik janë shumë komplekse dhe marrin shumë kur zbatohen deri në formulimin e rezultateve, ashtu që nuk mbetet kohë për detyrat tjera të rëndësishme.

1.4 Notimi

Notimi është proces i sigurimit të informatave, që përdoren për të sjellë vendime për vlerësimin e të arriturave të nxënësit, për përgatitjen e plan-programit mësimor dhe për orientimin e punës së politikës arsimore (Ferizado, M 2023; Mentero, V dhe të tjerët, 2021; Hopfenbeck, N. Th 2018; Musai, B 2014; Gjerard, T dhe Kiçing, K 2007; Nitko, 2004) ⁱⁱⁱ.

Notimi është pjesë përbërëse e procesit mësimor (mësimi dhe mësimdhënies), është pjesë integruese e ligjërimit, përfshin mbledhjen e informatave për të përsosur ligjërimin e mësimdhënësve dhe të mësuarin e nxënësve të tyre. Çdo aktivitet i bërë i nxënësit mund të përdoret për notim. (Hein dhe Price, 1994). Ekziston lidhje e qartë në mes qëllimit, përmbajtjes së mësimi dhe notimit (mësimi, mësimdhënies dhe notimit).

- Mësimdhënia, mësimi dhe notimi janë procese, që mundësojnë koherencë në mësim.
- Në bazë të qëllimeve dhe përmbajtjeve mësimore varet se çka mësohet. Nga rezultatet e notimit varet si do të realizohet mësimi dhe nga cilat drejtime do të synojë.
- Notimi duhet të jetë gjithpërfshirës i njohurive kognitive, por duhet t'i marrë parasysh edhe dimensionet emocionale dhe sociale të mësimi.
- Notimi luan rol vendimtar në krijimin e atmosferës në orë sepse të gjithë proceset në esencë janë procese sociale, që zhvillohen në mjedisin shoqëror (Ferizado, M 2023; Black dhe Wiliam, 1998). Procedurat e vlerësimit duhet të jenë të drejta dhe transparente.
-




Figura 2: Lidhja në mësimdhënies, mësimi dhe notimit mundësojnë koherencë në mësim

Notimi i të arriturave të nxënësve në shkollat e Republikës e Maqedonisë së Veriut sipas Ligjit për arsim fillor^{iv} në Nenin 138 sipas paragrafeve 1, 2, 3, 4, 5, kpërcaktohen objektivate e vlerësimit si arritjet e nxënësve në shkollën fillore të kontrollohen në mënyrë

ⁱⁱⁱ shih: Zbatimi i standardeve të notimit të nxënësve 2008:8, Shkup.

^{iv} shih: Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 161/2019 dhe 229/2020
<https://www.google.com/search?q=Ligji+p%C3%ABr+arsim+fillor>

formative dhe përmbledhëse dhe regjistrohen me nota përshkruese dhe/ose numerike, në të gjithë lëndët. Vlerësimi përmbledhës (sumativ) me nota përshkruese ndodh në fund të tremujorit të parë, gjysmëvjetorit të parë dhe tremujorit të tretë në lista evidentuese për suksesin e çdo nxënësi, ndërsa në fund të vitit shkollor çdo nxënës pranon dëftesë me nota përshkruese prej në klasë të parë (I) deri në tremujorin e tretë të klasës së VI të arsimit fillor, kurse në fund të klasës së VI deri në klasë të IX merret dëftesa me nota numerike në pajtim me kriteret për vlerësim me numër që i përpilon Byroja për Zhvillimin e Arsimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Notat prej 2-5 janë kalimtare, ku nota më e lartë është shkëlqyeshëm (5), kurse jokalistare është nota pamjaftueshëm (1). Notat numerike janë:

- Shkëlqyeshëm (5), Shumë mirë (4), Mirë (3), Mjaftueshëm (2), Pamjaftueshëm (1).

1.5 Vlerësimi etik

Etika është pjesë e sistemit personal të vlerave, prandaj çdo njëri sillet në mënyrë etike, jo pse e detyron ligji, as se dikush e pret atë nga ai, por se ai beson se ashtu duhet të sillet. Etika është shkencë e reflektimit të zgjedhjes së veprimeve të sakta e të mira të një individi, që i vë në zbatim për përmbushjen e detyrave profesionale në situata të ndryshme të përditshmërisë profesionale sipas të drejtës dhe të mirës morale ose sipas besimit individual, në të cilin beson.

Etika është aktivitet i arsyes në kërkim të zbatimit të të drejtës dhe të mirës morale, por është e ndryshme nga morali. Ajo është shumë e lidhur me moralin, që u referohet normave shoqërore të miratuara dhe të bartura nga tradita në lidhje me virtytin dhe veshen. Morali është grumbullimi i normave, rregullave dhe sjelljeve, që shoqërojnë individin gjatë gjithë jetës së tij qoftë në aspektin profesional ose në përditshmëri. (shih: <https://acer.org.al/wp-content/uploads/2023/>).^v

Roli i etikës është zbatimi i porosive të moralit, normave, parimeve me kryerjen e përgjegjësisë profesionale për atë arritur një drejtësi dhe liri në drejtimin e sjelljes njerëzore.

Sjelljen e njeriut e përmirësojnë dijet e gjithanshme, që çdonjëri i reflekton në çdo profesion ose në përditshmëri me respektimin:

- e normave (e mira dhe e keqja në shoqëri),
- parimeve (përgjegjëshmëria ndaj përgjegjësisë në çdo profesion),
- bashkëveprimi me të tjerët gjatë ushtrimit të detyrës profesionale për mirëqenie kolektive
- zhvillimi permanent profesional për gjindshmëri në çdo situatë të përditshmërisë.

Vlerësimi etik i të arriturave të nxënësve nga mësimdhënësi bëhet kur informata kthyesë e vlerësimit nuk e lëndon personalitetin e nxënësit, por e orientojnë të gjejë mënyrë tjetër për të mësuar dhe për ta përmirësuar suksesin e tij. Vlerësimi etik i të arriturave të nxënësve nga mësimdhënësi arrihet në mënyrë profesionale kur mësimdhënësit i jepet

^v <https://acer.org.al/wp-content/uploads/2023/>

mbështetje edhe nga subjektet të tjera në shkollë, e jo t'i parashtrohen kërkesa të vazhdueshme nga ato.

1.5.1 Kodeksi i sjelljes etike për vlerësimin e të arriturave të nxënësve

Kodeksi i sjelljes etike u referohet të gjithë subjekteve, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë janë të inkuadruar në realizimin e procesit intern së të arriturave të nxënësve ose që janë kompetent për mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave dhe të rezultateve të tij. Përmbajtja e kodeksit:

- Kodeksi Etik është deklarata për përcaktimin e sjelljes etike së të punësuarve në arsim, që në mënyrë humane të angazhohen në punë edhe mbi atë nivel të përgjegjësisë, që kërkohet prej tyre në lidhje me vlerësimin. Të punohet me vullnet dhe përkushtim të madh.
- Udhërrëfyes për të punësuarit në arsim, për nxënësit dhe prindërit gjatë marrjes së vendimeve etike, që kanë të bëjnë me vlerësimin.
- Theksin e vlerave profesionale dhe njerëzore (të gjithë t'i promovojnë dhe respektojnë).

Kodeksi etik i vlerësimit realizohet nëse të gjithë subjektet i përmbahen udhëzimit për bashkëpunim të ndërsjellë për proces të vlerësimit objektiv dhe cilësorë të vlerësimit. Kodeksi u referohet përgjegjësisë morale dhe profesionale të:

- Nëpunësve të punësuar në institucione dhe përgjegjësve në nivel nacional dhe lokal.
- Drejtorëve dhe punëtorëve profesional në shkolla.
- Mësimdhënësve që i notojnë të arriturat e nxënësve.
- Prindërve të nxënësve.
- Nxënësve, të arriturat e të cilëve vlerësohen.

Kodeksi Etik në vlerësim ka për qëllim

- T'i ndihmojë mirëkuptimin e përbashkët të vlerësimit etik së të gjithë të interesuarëve.
- Të rritë etikën në vlerësimin e nxënësve, me çka e rrit edhe besimin në sistemin arsimor.
- Të mbështes vlerat personale dhe sjelljen profesionale së të punësuarve në arsim, të cilat në fakt kontribuojnë për të arritura të larta dhe cilësore të nxënësve.
- T'i nxis të punësuarit në arsim të bisedojnë dhe ta vlerësojnë etikën e veprimeve të tyre në procesin e mësimi.

Vlerat inicuese (nxitëse për fillim) për pranimin e parimeve të Kodeksit Etik dhe respektimi i tyre është çështje e sistemit personal të vlerave morale dhe çështje e ndërgjegjes së secilit individ, që është i përfshirë në procesin e vlerësimit të nxënësve.

Etika profesionale dhe kodi i komunikimit kërkojnë që mësimdhënësi në radhë të parë të ketë përgjegjësi dhe profesionalizëm, andaj çdo mësimdhënës është i obliguar të ushtrojë profesionin e tij sipas etikës, të demonstrojë vlera dhe parime morale, si:

ndershmëria, besueshmëria, konfidencialiteti, konflikti i interesit dhe përgjegjësia. (shih: <https://masht.rks-gov.net/wp>).^{vi}

Kodeksi Etik i Vlerësimit gjatë procesit të vlerësimit duhet të udhëhiqet nga këto vlera: respektimi, drejtësia, demokracia, integriteti, ndershmëria dhe guximi. (shih: Figura 1).




Figura 3: Vlerat personale morale për respektimin e Kodeksit Etik në Notim

1.5.2 Përcaktimet etike në shkolla fillore

Rregullat etike, që të gjithë mësime dhe mësuesit, por edhe të punësuarit të tjerë në shkollë duhet t'i respektojnë dhe gjatë vlerësimit të arriturave të nxënësve paraqiten në tabelën në vijim: ^{vii}

Tabela 2. Rregullat etike në shkolla për ngritjen e etikës në notim, që secili të niset nga vetvetja

Nëpunësit në institucione arsimore në nivel nacional dhe lokal pranojnë:	Drejtorët, bashkëpunëtorët profesionalë në shkolla pranojnë:	Arsimtarët pranojnë:	Prindërit pranojnë:	Nxënësit pranojnë:
Të sigurojnë përgatitje me kohë dhe miratim të akteve cilësore (ligje, rregullore, udhëzime etj.), që rregullohet vlerësimi i përparimit të nxënësit si dhe të kujdesen për zbatimin e tyre në praktikë.	Të krijojnë kulturë të vlerësimit të drejtë dhe korrektë në shkollë.	Të jenë të paanshëm objektivë, pozitivë, të hapur dhe të përgatitur që t'u japin mbështetje dhe ndihmë nxënësve gjatë procesit të Vlerësimit.	Ta mbështesin mësimin e fëmijëve të tyre përmes angazhimit për notim objektiv dhe etikë.	Të angazhohen për vlerësim të drejtë dhe korrektë të gjithë nxënësve dhe t'u kundërvihen të gjithë dukurive, që shpiejnë në vlerësim jo të drejtë.
Me kohë dhe pa anime të reagojnë ndaj ankesave, lutjeve dhe veprimeve të ngjajshme në lidhje me vlerësimin për zgjidhjen e të cilave	T'i mbrojnë të drejtat e privatësisë në vlerësimin e nxënësve.	Me sjelljen e tyre gjatë procesit të Vlerësimit të promovojnë vlera të larta morale dhe të jenë shembull për nxënësit.	Të përmbahen nga aktivitete që në mënyrë të paarsyeshme do t'i shpien fëmijët e tyre në gjendje më të mirë në aspekt të vlerësimit në	T'i respektojnë kërkesat dhe procedurat kontraktuale në lidhje me vlerësimin dhe të informohen për pasojat e

^{vi} <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ua-kodi-i-etik.pdf>

^{vii} <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ua-kodi-i-etik.pdf>

Merita Banjica
KRITERI I NOTËS MESATARE “SUKSES I SHKËLQYESHËM” NDIKON
NË VLERËSIMIN JOETIKË TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE NË SHKOLLA FILLORE

janë kompetentë pikërisht ata, ndërsa të cilat janë parashtruar nga ana e nxënësve dhe prindërve.			krahasim me fëmijët tjerë.	mosrespektimit të rregullave.
Informatat e vlerësimit, që mund t'i marrin zyrtarisht, të mos keqpërdoren, por të përdoren ashtu, që të mos sjellin pasoja negative ose të shpiejnë në vendime joadekuate në arsim.	Ta pengojnë keqpërdorimin eventual të rezultateve të vlerësimit në shkollë	Ta shmangin çdo situatë, që mund të paraqesë konflikt të interesave, sjellje të anuar dhe joparimore në procesin e vlerësimit.	T'i respektojnë vendimet dhe këshillat profesionale të arsimtarëve në lidhje me vlerësimin e fëmijëve të tyre.	Të mos parashtrojnë kërkesa të papranueshme në lidhje me vlerësimin e të arriturave të tyre.
Pozicionin profesional të mos e përdorin për qëllime private, që janë të lidhura me vlerësimin në ndonjë shkollë ose të ndonjë nxënësi.	Të sigurojnë proces të drejtë të ankesave në lidhje me vlerësimin.	Të refuzojë çdo lloj të ndërhyrjes ose blerjes së ofruar me qëllim, që t'i jepet notë tjetër nxënësit, nga ajo, që ai e meriton.	Te fëmijët e tyre- nxënës, të nxisin sjellje të nderhme dhe korrekte dhe me sjelljen e tyre në lidhje me vlerësimin të arriturave të nxënësve të jenë shembull për ta.	T'i respektojnë këshillat e arsimtarëve, që kanë të bëjnë me vlerësimin edhe mësimin.
		T'i kundërvihen sjelljes joetikë të subjekteve tjera në vlerësimin (nxënës, prindër, kolegë).	Te fëmijët e tyre t'i njohin dhe t'i pengojnë përpjekjet eventuale me veprime të palejueshme, që të fitojnë notë të kënaqshme, nga ajo që është objektivisht e merituar.	Të mos shërbehen me proceduara të palejueshme gjatë prezantimit të diturive dhe shkathtësive të kërkuara dhe të shmangin çfarëdo ndikimi, me qëllim që ndonjë nxënësi të përfitojë notë më të lartë nga ajo, që e meriton.
		Në procesin e vlerësimit të respektojë personalitetin e nxënësit, e jo të miqve .		
		Të mbajë llogari për privatësinë e nxënësit , ndërsa njohuritë për mësimin e tij të mos i ndajnë me persona të tjerë, që nuk pjesë e procesit të mësimin.		
		Të bashkëpunojë me kolegët me		

		qëllim, që vlerësimi të përmirësohet.		
		Gjatë vlerësimit të mos bëhet diskriminimi i nxënësve mbi çfarëdo baze (nacionale, religjioze, gjinore, racore, sociale etj.)		

2. Hulumtimi Empirik

2.1 Metodologjia e hulumtimit

2.1.1 Metodatat e hulumtimit

Metodat e përdorura në këtë hulumtim ishin të natyrës teorike për t’u sqaruar konceptet e vlerësimit dhe të natyrës empirike aplikative-aksionale, ku u përdorën pyetësorë gjysmë të strukturuar me pyetje të hapura për t’u reflektuar edhe qëndrimet e subjekteve të tjera për vlerësimin e të arriturave të nxënësve. Rezultatet e opinionëve të gjithë të anketuarve, paraqiten në tabela, analizohen me metodën sasiore, cilësore dhe krahasimtare, prej ku formulohen përfundimet.

2.1.2 Hipotezat

Ky kërkim empirik u iniciua sipas hipotezës së përgjithshme e natyrës kauzale (shkak-pasojë) për të ndriçuar çështjen e vlerësimit objektiv të të arriturave të nxënësve në shkollë fillore dhe për të zbuluar faktorët kauzalë për paraqitjen e kësaj dukurie në shkollë fillore.

- **Hipoteza e përgjithshme:** Përmbyshja e kriterit “sukses të shkëlqyeshëm” për regjistrim në shkollë të mesme medicinale bëhet shkak kryesor për vlerësimin joetikë dhe joobjektiv të të arriturave të nxënësve në shkollë fillore.
- **Hipoteza ndihmëse:** Kërkesat për rritje të notave të disa nxënësve të drejtuar nga disa subjekte në drejtim të mësimdhënësve ndikon në vlerësimin joobjektiv të të arriturave të nxënësve.
- **Hipoteza ndihmëse:** Vlerësimi joobjektiv i të arriturave të nxënësve i demotivon nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm për mësim në vazhdimësi, kurse i nxit nxënësit me sukses të dobët në manipulim e mashtrim të vetvetes.
- **Hipoteza ndihmëse:** Ndjekja e kurseve bëhet ngarkesë e madhe për nxënësit, që ndikon në edhe në mosinteresimin e nxënësit të shkëlqyeshëm për ta ndjekur mësimin në klasë.

2.1.3 Variablat

- **Variabla e pavarur:** Zbatimi i Kodit Etikë në Vlerësim

- **Variabla e varur:** Vlerësimi i merituar i të arriturave të çdo nxënës është në varësi nga vlerësimi profesional i mësimdhënësit lëndor, i mbështetur në vlerësim objektiv dhe vlerësim etik, por edhe kërkesa e subjekteve të tjera në shkollë.

2.1.4 Mostra (Sondazhi)

Ky kërkim empirik u zbatua më 23 -29 janar 2023 në Shkollën Fillore "Ismail Qemali"-Gostivar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Anketimi u zhvillua me 56 nxënës të klasave të shtata, me 56 prindër dhe 14 mësimdhënëse, që ligjërojnë në ato klasa. Mostra e këtij hulumtimi ishte e qëllimshme e rastësishme. Gjithsej u anketuan 126 individ.

Ky hulumtim të hulumtohet te të njëjtë nxënës (56 nxënës) edhe vitin e ardhshëm shkollor si nxënës të klasës së tetë (VIII -2024) dhe të nëntë (IX -2025) me një pyetësor të njëjtë të përgatitur me 8 pyetje të hapura në Fokus Grupe në paralele të ndryshme. Anketimi i dytë dhe i tretë u zbatua më 13.02.2024-13.02.2025 në Shkollën Fillore "Ismail Qemali"-Gostivar.

2.2 Gjetjet dhe rezultatet e anketimit

Hulumtimi u realizua me anë të anketimit ku u përdorën tre pyetësorë të strukturuar me 14 pyetje të hapura me përzgjedhjen e disa opsioneve për situata të ndryshme për mësimdhënëse, prindër dhe nxënës në lidhje me çështjen e vlerësimit profesional, objektiv dhe etik të së arriturave të nxënësve në këtë shkollë.

Mirëpo pas analizimit të tri pyetësorëve lindi nevoja për të bërë edhe një pyetësor tjetër për ta zbatuar për anketimim me të njëjtët nxënës, por tani më të rritur si nxënës së klasës së VIII, që u zhvillua më shkurt të vitit 2024 dhe në shkurt të vitit 2025. Ky hulumtim trivjeçar u zhvillua për ta zbuluar çështjen e vlerësimit joetik në shkolla dhe për t'i zbuluar faktorët, që ndikojnë për vlerësimin joobjektiv të të arriturave të nxënësve, që në klasë të IX reflektohet me demotivim të nxënësve të shkëlqyeshëm ndaj të mësuarit në vazhdimësi. Të gjithë të gjetjet dhe rezultatet e ndriçuara pasqyrohen në tabela sipas pyetësorëve të përdorur në anketimin e mësimdhënësve Pyetësori-A, anketimin e prindërve Pyetësori-B, anketimin e nxënësve Pyetësori-C dhe anketimin e nxënësve Pyetësori-D.

Pyetësori -A - Pyetësor Për Mësimdhënëse

Mësimdhënëse i nderuar,

*Në këtë pyetësor janë dhënë disa mendime, por ka të parashtuara edhe disa pyetje të hapura për t'i shprehur edhe Ju disa mendime. Ju lutem përgjigjuni me sinqeritet në hapësirë e zbrazët poshtë !
Ju falënderoj për kohën që e ndatë për ta plotësuar këtë pyetësor!*

25.01.2023, Gostivar

Pyetësi-A-Situata Të Ndryshme

Tabela 1-A: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për mësimdhënës-A

1. Një mësimdhënës/e vazhdimisht pranon dhuratë nga prindërit e disa nxënësve. Si e vlerësoni ju marrjen e dhuratës ?	Frekuenca	%
Unë pranimin e dhuratës nga prindërit e nxënësve e vlerësoj si respekt ndaj meje, por edhe marrjen e dhuratës e konsideroj si respekt ndaj dhuruesit, qoftë e lirë ose e shtrenjtë dhurata nuk kthehet, por pranohet nga prindi i çdo nxënësi.	2	14%
Unë në fillim të vitit nxënësve ua jap në dije, që të mos më sjellin dhurata, por edhe nëse më sjellin të jetë simbolike dhe e lirë, e jo dhuratë e shtrenjtë.	1	7%
Unë pranimin e dhuratës nga prindërit e nxënësve e vlerësoj si shpërblim.	1	7%
Unë marrjen e dhuratës e shoh si veprim jo të mirë, pasi që nxënësi menjëherë krijon bindje se duhet të jetë më i privilegjuar se të tjerët ose pret notë më të mirë pa meritë.	4	29%
Unë dhuratën nga prindi i nxënësit e vlerësoj shumë se më stimulon për punë.	2	14%
Unë marrjen e dhuratës nga prindi e konsideroj si veprim jo të mirë, prandaj nuk e pranoj.	4	29%
Total	14	100%

Në pyetjen 1 janë shprehur 14 (100%) mësimdhënës, prej të cilëve në opsionin 1 janë shprehur 2 (14%) mësimdhënës se dhuratën nga prindërit e nxënësve e konsideron si mirënjohje ndaj punës së tij, por edhe si respekt ndaj prindit që ia dhuron se dhurata nuk kthehet, kurse në opsionin 2 dhe 3 janë shprehur nga 1 (7%) mësimdhënës që dhuratën e shohin si shpërblim për punën e bërë. Në opsionin 4 janë shprehur 4 (29%) mësimdhënës, që dhuratën e konsiderojnë si mirënjohje ndaj punës së tij, por dhe si respekt ndaj nxënësve, që ia dhurojnë se dhurata nuk kthehet. Në opsionin e 6 janë shprehur 4 (29%) mësimdhënës, të cilët marrjen e dhuratës nga nxënësi e konsiderojnë si mjet jo të mirë, që përdoret për t'iu dhënë privilegji më të madhe nxënësve. Në opsionin pestë janë shprehur 2 (14%) mësimdhënës, që dhuratën e konsiderojnë si stimulim për motivim për punë.

Tabela 2-A: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për mësimdhënës-A

2. E keni kuptuar se një mësimdhënës i shkollës vazhdimisht i ofendon nxënësit, kur ata janë të dobët në dituritë e tyre, duke u thënë: torrollak, përtacë, idiot etj. Si veproni ju ndaj këtij veprimi të këtij mësimdhënësi?	Frekuenca	%
Unë nuk i ofendoj nxënësit e pasuksesshëm, prandaj edhe do të reagoj te mësimdhënësi.	8	57%
Unë ndonjëherë e ofendoj nxënësin e pasuksesshëm, që të turpërohet dhe të nxitet të mësojë në të ardhmen.	1	7%
Unë nuk e shoh të arsyeshme ofendimin e nxënësve, që nuk tregojnë sukses në të mësuarit, prandaj nëse e kuptoj se ndonjë mësimdhënës e ofendon ndonjë nxënësi unë do të reagoj te udhëheqësi i shkollës dhe pedagogu për ta këshilluar atë, që të reflektojë sjellje etike profesionale.	1	7%
Unë mendoj se mësimdhënësi ka bërë gabim se nxënësit aspak nuk duhet të ofendohen	4	29%
Total	14	100%

Në pyetjen 2 vërehet në opsinin 1 opinionin e tyre e kanë shprehur 8 (57%) mësimdhënës dhe në opsinin 4 janë shprehur 4 (29%) , që e dinë se nxënësi nuk duhet të ofendohet në klasë, por edhe nëse ka mësimdhënës së tillë e paraqesin te drejtoria që të merren masa ndaj tij për ta përmirësuar sjelljen ndaj nxënësve. Në opsionet 2 është shprehur vetëm 1 (7%) mësimdhënës, që opinionin e tij e shpreh se nxënësi duhet të ofendohet, që të turpërohet dhe të motivohet të mësojë, kurse në opsinin 3 është shprehur vetëm 1 (7%) mësimdhënës që opinionin e tij e shpreh se mësimdhënësit të tillë duhet pedagogia e shkollës t'i mbajë një ligjëratë për ta përmirësuar sjelljen ndaj nxënësve.

Tabela 3-A: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësorin për mësimdhënës-A

3. E keni kuptuar se një mësimdhënës, të cilin ju e çmoni shumë për Vlerësimin objektiv se nxënësit e klasës suaj i ka notuar joobjektivisht, u ka ndihmuar shumë nxënësve të dobët duke i barazuar arritjet e tyre me nxënësit shembullorë. Si do të veproni Ju në këtë rast?	Frekuenca	%
Unë ndonjëherë detyrohem të bëjë barazime të tilla në notim, prandaj nuk i bëj vërejtje.	3	21%
Unë nuk bëj barazime të tilla në notim, por mbështetem në vlerësimet formative, prandaj mësimdhënësit do t'i jap vërejtje, por do të ankojem edhe te drejtori i shkollës.	4	29%
Mësimdhënësi ka bërë gabim se i ka barazuar nxënësit e dobët me nxënësit shembullorë.	6	43%
Unë do ta nxis nxënësin të mësojë, që me meritë të marrë notë të shkëlqyeshme.	1	7%
Total	14	100%

Në pyetjen 3 janë shprehur 6 (43%) mësimdhënës se nëse ndonjë mësimdhënës i vlerëson nxënësit joobjektivisht është në gjendje rastin ta paraqesë në drejtori, por edhe vet t'i drejtohet mësimdhënësit për ta kuptuar shkakun e vlerësimit joobjektiv.

Tabela 4-A: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësorin për mësimdhënës-A

4. E keni kuptuar se i mbani mësim fëmijës së drejtorit.....etj., por në lëndën tuaj ai nuk reflekton dije për notë më të lartë, por ju e dini se prindi i tij do të kërkojnë të ketë notë të shkëlqyeshme dhe arritjet e tij i barazoni me nxënësit shembullorë. Si do të veproni Ju në këtë rast?	Frekuenca	%
Unë në shenjë respekti ndaj drejtorit, etj. ia rris notën fëmijës së tij pa me më lutur asnjë.	6	43%
Unë në shenjë respekti ndaj drejtorit, ...etj. nuk bëj rritje të notës pa meritë, por i jap mundësi fëmijës së tij të të përgjigjet edhe njëherë për të marrë notë më të lartë.	5	36%
Unë do ta kisha ndihmuar vetëm me rritjen e një note, e jo të tri notave.	2	14%
Unë në shenjë respekti do ta kisha notuar objektivisht fëmijën e drejtorit..... etj.	1	7%
Total	14	100%

Në pyetjen 4 shumica e mësimdhënësve 6 (43%) janë shprehur se në shenjë respekti ndaj drejtorit fëmijës së tij (zëvendës drejtorit dhe bashkëpunëtorëve profesional) nota u rritet menjëherë.

Tabela 5-A: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësonin për mësimdhënës-A

5. Një mik i afërt juaj ju ka lutur të intervenoni te një mësimdhënës, me të cilin keni miqësi, të kërkonit fëmijës së tij t'i japë notë të shkëlqyeshme për t'u regjistruar më lehtë në shkollë të mesme. Si do të veproni Ju në këtë rast?	Frekuenca	%
Unë ndonjëherë ndjehem shumë ngushtë nga disa miq, detyrohem t'i lus disa kolegë t'ia rrisin notën fëmijës së tij për t'u regjistruar në shkollë të mesme.	8	57%
Unë ndonjëherë ndjehem shumë ngushtë nga disa miq, por nuk e lus asnjë kolegë t'ia rris notën fëmijës së tij për t'u regjistruar në shkollë të mesme.	4	29%
Unë në ndonjë rast mund të intervenojë vetëm te një kolegë, vetëm nëse i nevojitet edhe një pesë për sukses të shkëlqyeshëm.	2	14%
Total	14	100%

Në pyetjen 5 janë shprehur 8 (57%) mësimdhënës se kërkesa për notë mesatare më të lartë për regjistrim në shkollë të mesme i detyron të bëhen joobjektiv në notim, për shkak të kërkesës, që ua bëjnë miqtë e tyre, por ka edhe të tillë, që nuk i lusin kolegët për notën e fëmijës së mikut.

Tabela 6-A: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësonin për mësimdhënës-A

6. Nxënësit ankohen se mësimdhënësi nuk ua sqaron kriteret e vlerësimit, prandaj janë reflektuar shumë nota të dobëta në teste, por mësimdhënësi arsyetohet se nuk ka nevojë t'u jap sqarime shtesë se në fillim të vitit ua ka sqaruar kriteret dhe se nota është formuluar sipas arritjes së pikëve në bazë të kriterëve të prashtruara. Si do të veproni Ju?	Frekuenca	%
Unë para çdo testi ua tregojë kriteret e vlerësimit nxënësve dhe nuk jap sqarime shtesë për notën e formuluar, prandaj nuk do të reagoj te asnjë mësimdhënës për të dhënë sqarime.	3	21%
Unë jap sqarime shtesë për notën e formuluar, por nëse ka ndonjë ankesë përsëri e kontrolloj testin ose nëse ndodh në ndonjë lëndë tjetër e lus kolegun t'ia kontrollojë testin nxënësit.	7	50%
Unë kriteret e vlerësimit nxënësve ua tregojë në fillimin e vitit shkollor dhe u them se nuk bëj korrigjime të notave pasi i formuloj, prandaj nuk do të reagoj te mësimdhënësi.	4	29%
Total	14	100%

Në pyetjen 6 janë shprehur 7 (50%) mësimdhënës se japin sqarime shtesë për notën e formuluar, por nëse ka ndonjë ankesë nga ndonjë nxënës, bëhet edhe njëherë kontrollimi i testit ose nëse ndodh edhe te ndonjë lëndë tjetër i bën kërkesë kolegut t'ia kontrollojë testin edhe njëherë.

Tabela 7-A: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësonin për mësimdhënës-A

7. Një arsimtar (drejtor, pedagog, inspektor, punëtor profesionale etj) para kolegëve tregon detaje të gjendjes familjare të një nxënësi, që ai i ka kuptuar nga prindi i nxënësit, pastaj e arsyeton reflektimin e suksesit të dobët të nxënësit dhe insiston t'i përmirësohen notat si mëshirë ndaj gjendjes së vështirë të tij. Si do të veproni Ju në këtë rast?	Frekuenca	%
Unë nuk bëhem human ndaj nxënësve me gjendje sociale të vështirë duke ua rritur notën, por nëse kam mundësi e ndihmojë me diçka materiale ose me mjete financiare.	2	14%
Unë çdo herë te nxënësit me gjendje të vështirë sociale bëj lëshim në notë.	4	29%
Unë nuk bëj lëshim në notë te nxënësi i dobët me gjendje të vështirë sociale, por e nxis të mësojë.	8	57%
Total	14	100%

Në pyetjen 7 janë shprehur 8 (57%) mësimdhënës se janë objektiv dhe nxënësit me gjendje të vështirë sociale i detyrojnë të mësojnë, por nuk ua rrisin notat pa meritë.

Tabela 8-A: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësonin për mësimdhënës

8. Prindi i një fëmije çdo ditë vjen në shkollë për të pyetur për arritjet e fëmijës së tij dhe nuk i pranon shpjegimet për reflektimin e suksesit të dobët të fëmijës së tij, por kërkon pa meritë t'i përmirësohen notat në të gjithë lëndët. Si do të veproni Ju?	Frekuenca	%
Unë nuk ia përmirësojë notën nxënësit nëse ai nuk mëson, edhe pse prindi insiston për ta kaluar shkëlqyeshëm se i nevojitet për t'u regjistruar në shkollë të mesme.	2	14%
Unë nxënësin do ta pyes para tij dhe do t'ia tregoj dosjen e instrumenteve vlerësuese.	6	43%
Unë do t'ia fal një notë, por nuk e barazojë me arritjet e nxënësve shembullorë.	4	29%
Unë, për ta larguar pengesën, që prindi na e shkakton në mësim, ia rris fëmijës së tij notën	2	14%
Total	14	100%

Në pyetjen 8 janë shprehur 6 (43%) mësimdhënës se dosja me instrumentet vlerësuese është dëshmi për arritjet e nxënësit, por 4 (29%) mësimdhënës janë shprehur se nëse prindi kërkon t'i rritet nota fëmijës së tij, ato menjëherë ia rrisin notën nxënësit.

Tabela 9-A: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësonin për mësimdhënës

9. Një mësimdhënës i noton nxënësit më rreptë se mësimdhënësit tjerë, madje krenohet se si ai/ajo është e rreptë dhe i/e drejtë. Si do të veproni Ju në këtë rast?	Frekuenca	%
Unë mësimdhënësit ia jap në dije se mënyra e vlerësimit të tij është e gabuar dhe duhet të jetë i drejtë gjatë vlerësimit të nxënësve.	6	43%
Unë e lus një mësimdhënës homolog të tij për t'i kontrolluar testet edhe njëherë për ta konstatuar vlefshmërinë e vlerësimit të tij.	2	14%
Unë mendoj se nuk është i profesionalizuar për vlerësimin formativ dhe përmbyllës, prandaj do të propozojë ta ndjek trajnimin për vlerësimin objektiv dhe vlerësimin etikë.	2	14%
Unë mendoj se një mësimdhënës i tillë e imponon autoritetin e tij para nxënësve për ta pasur frikë, prandaj unë nuk mund të reagojë.	4	29%
Total	14	100%

Në pyetjen 9 janë shprehur 6 (43%) mësimdhënës se janë të gatshëm t'i drejtohen kolegut nëse vlerësimi i tij është i gabuar, disa 2 (14%) do të kërkojë nga homologu i kolegut t'i kontrollojë edhe njëherë teste, ndërsa disa e bëjnë qëllimisht për ta imponuar autoritetin e tij para nxënësve, që ta kenë frikë ose prindërit të vijnë ta lusin dhe ta shpërblejnë mirësinë e tij ose e bën qëllimisht, që nxënësit ta kenë frikë.

Tabela 10-A: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësonin për mësimdhënës-A

10. Një fëmijë i një familje me gjendje të dobët sociale ka nota të dobëta në shumë lëndë mësimore. Kujdestari i klasës (drejtori.....etj) i lut mësimdhënësit t'i japin nota më të larta se situatën familjare e ka të përkeqësuar. Si do të veproni Ju në këtë rast?	Frekuenca	%
Unë kërkesat e kujdestarit të klasës për rritje të notës së ndonjë nxënësi i respektoj, edhe nëse nxënësi nuk mëson.	2	14%
Unë nuk i plotësoj kërkesat e kujdestarit, nëse nxënësi nuk mëson, por do ta notoj objektivisht.	7	50%
Unë e di se në asnjë profesion nuk ka objektivitet, ashtu që edhe në profesionin e mësimdhënësit ndodhin këto lëshime ndaj nxënësve me gjendje të vështirë sociale.	5	36%
Total	14	100%

Në pyetjen 10 janë shprehur 7 (50%) mësimdhënës se nuk e plotësojnë kërkesën e kujdestarit të klasës për t'ia rritur ndonjë nxënësi notën pa meritë, por të shumica e mësimdhënësve i rrisin notat të nxënësve me gjendje të vështirë sociale 5 (36%), por ka edhe të tillë 2 (14%) që i rrisin notat e nxënësve nëse kujdestari i klasës bën një kërkesë të tillë.

Tabela 11-A: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësonin për mësimdhënës-A

11. E vëreni se një nxënës në e-ditar menjëherë ka më shumë nota të përmirësuar në shumë lëndë, por përmirësimet në të mësuarit e tij nuk vërehen. Si do të veproni Ju?	Frekuenca	%
Unë rastin e paraqes drejtori i shkollës dhe kërkoj nga mësimdhënësi lëndorë t'ia shënojë notat e para në e-ditar, që të bëhet krahasimi i notave .	4	29%
Unë nuk reagoj aspak se e di se mësimdhënësit vet i kanë përmirësuar notat e nxënësit se vetëm ai kanë qasje në e-ditar ose prindi ia ka arritur qëllimit ta kalojë fëmijën me sukses të shkëlqyeshëm se kujdestarët e klasave nuk mund t'i përmirësojnë notat në lëndët tjera në e-ditar.	10	71%
Total	14	100%

Në pyetjen 11 janë shprehur 10 (71%) mësimdhënës se nuk reagojnë aspak, për shkak se e din se mësimdhënësit vetë i kanë bërë përmirësimet se vetëm ata kanë qasje në e-ditar, por prindi ka qenë shumë aktiv dhe e ka bindur mësimdhënësin e lëndës se fëmija i tij duhet të kalojë me “sukses të shkëlqyeshëm” se i nevojitet për regjistrim në shkollë të mesme.

Tabela 12-A. Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësonin për mësimdhënës-A

12. Nxënësit ankohen se arsimtari i matematikës (fizikës, biologjisë, gjuhës angleze, gjermane, informatikë..) të gjithë nxënësve u ka vënë notë të dobët sepse nuk shkojnë në kurs (mësim shtues si aktivitet jashtëmësimor). Si do të veproni Ju në këtë rast?	Frekuenca	%
Unë nuk pajtohem me këtë veprim, rastin do ta paraqesë te drejtori i shkollës.	4	29%
Unë rastin do ta konsultojë me mësimdhënësin nëse ka ankesa nga prindërit.	3	21%
Unë rastin do ta paraqesë para Këshillit të Mësimdhënësve, që të gjithë mësimdhënësit e kurseve të vetëdijësohen se janë duke bërë gabim dhe të mos i detyrojnë nxënësit të shkojnë në kurse.	4	29%
Unë do të ju them prindërve t'i dërgojnë fëmijët në kurs, që të kenë notë të shkëlqyeshme.	2	14%
Unë mendoj angazhimi në kurs bëhet sipas dëshirës personale, e jo me detyrimin e mësimdhënësit.	1	7%
Total	14	100%

Në pyetjen 12 në opsionin e parë janë shprehur 4 (29%) mësimdhënës se nëse mësimdhënësi i detyron nxënësit të shkojnë në kurs, rastin do ta paraqesin te drejtorja e shkollës, mirëpo 3 (21%) mësimdhënës janë shprehur se rastin do ta konsultojë me kolegun, por 2 (14%) mësimdhënës janë shprehur se disa kujdestarë klase ua japin në dije nxënësve se nëse nuk shkojnë në kurs në fund të vitit do të kenë probleme me notat.

Tabela 13-A: Opinione të ndryshme të paraqitura në pyetësonin për mësimdhënës-A

13. Nxënësit ankohen se arsimtari i një lënde para se ta bëjë testimin nuk bën përsëritje me nxënësit për t'i përforcuar dituritë e tyre për materialin e zhvilluar Si do të veproni Ju ?	Frekuenca	%
Unë çdo herë një orë para testimit zhvilloj përsëritje me nxënësit për materialin e zhvilluar, prandaj do ta kisha lutur mësimdhënësin para se ta bëjë testimin të bëjë përsëritje të materialit një orë para.	10	71%
Unë një orë para testimit nuk bëj përsëritje verbale me nxënësit për materialin e zhvilluar se mendoj se ua tregoj pyetjet dhe përgjigjet e nuk mund t'i masë dijet e qëndrueshme në memorien e tyre.	4	29%
Total	14	100%

Në pyetjen 13 janë shprehur 10 (71%) mësimdhënës se çdoherë para zbatimi të testimit duhet bëhet përsëritje në klasë, ndërsa 4 (29%) mësimdhënës janë shprehur se nuk duhet të bëhet përsëritje para testimit se nuk mund t'i vlerësojnë dijet e qëndrueshme nxënësve.

Tabela 14-A: Opinione të ndryshme të paraqitura në pyetësonin për mësimdhënës-A

14. Nxënësit ankohen se arsimtari i një lënde para se ta realizojë testimin nuk i orienton nxënësit për plotësimin e testit. Si do të veproni Ju në këtë rast?	Frekuenca	%
Unë çdo herë në fillim të orës nxënësve u jap sqarime për mënyrën e plotësimit e testit, prandaj do ta kisha lutur edhe mësimdhënësin lëndor t'iu jep sqarime nxënësve për plotësimin e testit.	11	79%
Unë çdo herë në fillim të orës nxënësve nuk u jap sqarime për mënyrën e plotësimit e testit, prandaj nuk e lus edhe mësimdhënësin lëndor ta bëjë një gjë të tillë.	2	14%
Unë çdo herë në fillim të orës nxënësit i orientoj për plotësimin e testit, për shkak se ato bëjnë shumë teste në të gjithë lëndët dhe ndonjëherë mund t'u paraqitet ndonjë konfuzion për plotësimin e testit	1	7%
Total	14	100%

Në pyetjen 14 janë shprehur 11 (86%) mësimdhënës se çdoherë para zbatimi të testimit nxënësve u japin sqarime për plotësimin e testit, që të mos ketë paqartësi se ato bëjnë shumë teste në lëndë të ndryshme, kurse 2 (14%) mësimdhënës nuk u japin sqarime nxënësve për plotësimin e testit.

Përfundime nga opinionet e reflektuara në pyetësonët e mësimdhënësve-Pytësoni-A

- 1) Mësimdhënësit dhuratën e konsiderojnë si respekt, shpërblim për punën e bërë ose stimulim për motivim për punë në të ardhmen, ndërsa ka edhe të tillë, që nuk duan të pranojnë dhuratë prej ndonjë nxënësi se nxënësi atëherë ndjehet më i privilegjuar se të tjerët në klasë.
- 2) Shumica e mësimdhënësve 8 (57%) kanë arritur kulturë për ta zbatuar mësimdhënien moderne duke i trajtuar nxënësit si bashkëveprues gjatë mësimdhënies, mirëpo ka edhe të tillë, që konsiderojnë veten si "Zot në klasë" duke reflektuar sjellje autoritare ndaj nxënësve.

- 3) Mësimdhënësit kanë arritur kulturë për ta zgjidhur vet rastin vet me mësimdhënësin.
- 4) Shumica e mësimdhënësve janë shprehur se në shenjë respekti ndaj drejtorit (zëvendësdrejtorit dhe bashkëpunëtorit profesional, kolegut) fëmijës së tij menjëherë ia rrisin notën pa mos iu drejtuar askush të kërkojë notë për atë nxënës.
- 5) Shumica e mësimdhënësve 8 (57%) janë shprehur se kërkesa për notë mesatare të shkëlqyeshme për regjistrim në shkollë të mesme i detyron të bëhen joobjektiv dhe joetikë në notim se të gjithë subjektet u bëjnë kërkesa të pandërprera për rritje të notave.
- 6) Shumica e mësimdhënësve janë shprehur se japin sqarime shtesë për notën e formuluar ose bëhet kontrollimi i testit edhe njëherë.
- 7) Shumica e mësimdhënësve 8 (57%) janë shprehur se notimi i nxënësve me gjendje të vështirë sociale është objektiv dhe i detyrojnë të mësojnë, por nuk ua rrisin notat pa meritë.
- 8) Shumica e mësimdhënësve 6 (43%) janë shprehur se dosja me instrumentet vlerësuese janë dëshmi për arritjet e nxënësit, nëse ndonjë prind kërkon t'i rris fëmijës së tij notën, por ka edhe të tillë, që nëse prindi i kërkon notë më të lartë menjëherë ia rrisin notën nxënësit.
- 9) Shumica e mësimdhënësve 6 (43%) janë të gatshëm t'i drejtohen kolegut nëse vlerësimi i tij është i gabuar, disa 2 (14%) do të kërkojë nga kolegu t'i kontrollojë edhe njëherë testet. Disa mësimdhënës 4 (29%) i ulin notat qëllimisht për ta imponuar autoritetin e vet para nxënësve, që ta kenë frikë nxënësit ose prindërit ta lusin dhe ta shpërblejnë mirësinë e tij.
- 10) Shumica e mësimdhënësve 7 (50%) janë shprehur se nuk e plotësojnë kërkesën e kujdestarit të klasës për t'ia rritur notat pa meritë një nxënësi me gjendje të vështirë sociale, por ka edhe të tillë, që i rrisin notat 5 (36%) nëse ndonjë subjekt tjetër nga shkolla u bën kërkesë të tillë.
- 11) Shumica e mësimdhënësve janë shprehur se vet mësimdhënësit i bëjnë përmirësimet e notave se askush tjetër nuk ka qasje në e-ditar.
- 12) Shumica e mësimdhënësve janë shprehur se mësimdhënësit nxitës të nxënësve për të ndjekur kursin e tyre duhet t'i paraqesin te drejtori, por disa janë shprehur se duhet të shkojnë në kurs se në fund të vitit do të kenë probleme me notat, nëse nuk shkojnë.
- 13) Shumica e mësimdhënësve janë shprehur se një orë para zbatimi të testimit nxënësit duhet të bëjnë përsëritje në klasë, ndërsa disa mësimdhënës janë shprehur se nuk zhvillojnë përsëritje një orë para testimit se atëherë nuk mund t'i masë dijet e qëndrueshme të nxënësve.
- 14) Shumica e mësimdhënësve janë shprehur se para çdo testimi nxënësve u japin sqarime për plotësimin e testit, prandaj kërkojnë edhe të tjerët ta bëjnë një gjë të tillë.

Pyetësor Për Prind-B

Prind i nderuar,

Në këtë pyetësor janë dhënë disa mendime, por ka të parashtruara edhe disa pyetje të hapura për t'i shprehur edhe Ju disa mendime në lidhje me vlerësimin e të arriturave të nxënësve.

Ju lutem përgjigjuni me sinqeritet në hapësirën poshtë!

Ju falënderoj për kohën që e ndatë për ta plotësuar këtë pyetësor!

25.01.2023, Gostivar

Pyetësi-B-Situata Të Ndryshme

Ju si prind si do të veproni në situata të ngjashme me këto?

Tabela 1-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

1. Një prind i paraleles së fëmijës suaj vazhdimisht u dhuron dhuratat të shtrenjta disa arsimtarëve. Si veproni Ju ?	Frekuenca 56 prind	%
Ka disa prind, që i dhurojnë dhuratë të shtrenjtë mësimitdhënësit, që t'ia përmirësojë notën fëmijës së vet.	8	14%
Në klasën, ku fëmija ime mëson, të gjithë prindërit u japin të holla fëmijëve për t'i blerë mësimitdhënësit kujdestar dhuratë të përbashkët, të cilën ia dhurojnë për 7 Mars.	16	29%
Po, ndonjëherë është mirë t'i dhurojë mësimitdhënësit dhuratë si falënderim për punën e tij.	16	29%
Jo, nuk është mirë arsimtari të merr dhuratë prej prindit të nxënësit	4	7%
Jo, nuk kam kuptuar se ndonjë prind i sjellë ndonjë arsimtari dhuratë të shtrenjtë, por edhe unë nuk i kam dhënë asnjë dhuratë.	4	7%
Po ka prind të tillë, u sjellin arsimtarëve dhurata, që fëmija i tij të jetë në qendër të vëmendjes ose më i privilegjuar se të tjerët.	8	14%
Total	56	100%

Në pyetjen 1 shumica e prindërve 16 (29%) janë shprehur se mësimitdhënësit kujdestar është mirë t'i jepet dhuratë për ndonjë festë, por ka edhe prindër 16 (29%) që shprehen se dhurata duhet të blihet nga buxheti i përbashkët i nxënësve së klasës, që asnjë nxënësi të mos e ndjen vetën të privilegjuar e as të diskriminuar. Mirëpo ka prind 8 (14%) , që janë shprehur se ka prind që mësimitdhënësit i blejnë dhuratë, që t'ia përmirësojë notat fëmijës së tij dhe fëmija i tij të ketë privilegji.

Tabela 2-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

2. E keni kuptuar se një mësimmhënës i shkollës vazhdimisht i ofendon nxënësit, që nuk dinë duke u thënë: torrollak, përtacë, idiot, injorant, budalla etj. Si veproni ju ndaj këtij mësimmhënësi?	Frekuenca	%
Po e kam kuptuar se ma ofendon fëmijën tim, kur ai nuk përgjigjet saktë dhe jam ankuar te kujdestari i klasës, ashtu që sjellja e mësimmhënësit tani ka ndryshuar.	12	21%
Po e kam kuptuar se ma ofendon fëmijën, prandaj shkova dhe bisedova me të.	2	4%
Po, e kam kuptuar se i ofendon nxënësit, që nuk mësojnë, ndoshta dëshiron t'i turpërojë ata, që të fillojnë të mësojnë më tepër.	4	7%
Unë nuk kam dëgjuar një gjë të tillë.	10	18%
Arsimtarit ka të drejtë ndonjëherë edhe ta ofendojë nxënësin se vetëm në atë mënyrë fëmija e kupton gabimin dhe fillon të mësojë.	2	4
Po, ka arsimtar, që i ofendon nxënësit, që nuk dinë, por kjo gjë nuk është në rregull.	14	25%
Po, ka arsimtar që i ofendon nxënësit kur nuk dinë, ndoshta dëshiron prindi ta kuptojë se fëmijën e ka të paimterësuar për mësim dhe t'i sjellë ndonjë dhuratë arsimtarit, që t'i jap një notë kaluese ose t'i bëjë ndonjë shërbim tjetër ose ta regjistrojë në kurs.	12	21%
Total	56	100%

Në pyetjen 2 shumica e prindërve 14 (25%) janë shprehur se në shkollën fillore ka arsimtarë, që i ofendon nxënësit dhe përdor ndonjëherë edhe ndonjë shuplakë ose dhunë fizike, kurse disa qëllimisht ia ulin interesimin nxënësit 12 (21%), që të takohen me prindin e nxënësit t'i sjellë ndonjë dhuratë arsimtarit, ta regjistrojë fëmijën në kurs ose t'i bëjë ndonjë shërbim tjetër. Disa prind 12 (21%), janë shprehur se e kanë kuptuar se mësimmhënësi e ofendon fëmijën tij, kur ai nuk përgjigjet saktë dhe se janë ankuar te kujdestari i klasës, ashtu që sjellja e mësimmhënësit tani ka ndryshuar. Disa mësimmhënës 10 (18%), shprehen se nuk kanë dëgjuar një gjë të tillë.

Tabela 3-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

Fëmija juaj ankohet se një arsimtar, që ju çmoni shumë, nuk e vlerëson fëmijën tuaj objektivisht.	Frekuenca	%
Mësimmhënësi nuk është i drejtë në Vlerësimin e djalit tim, pasi që ai nuk më njeh mua, kurse ndaj të fëmijëve të tjerë bën lëshime. Unë do të shkoj t'ia jap në dije se nuk është objektiv në vlerësimin e diturive të nxënësve.	12	21%
Unë do të shkoj ta pyes përse nuk e vlerëson objektivisht fëmijën tim, ndoshta fëmija im ka bërë ndonjë problem, që unë nuk e di.	8	14%
Mësimmhënësi ndoshta ka ndonjë arsye përse nuk e vlerëson objektivisht fëmijën tim, prandaj do të shkoj të bisedoj me të për ta kuptuar të vërtetën.	8	14%
Fëmija ime nuk është ankuar për padrejtësi në notim.	16	29%
Po, jam befasuar kur e kuptova se arsimtari nuk vlerëson fëmijën tim objektivisht, por nuk do të reagoj se ai dëshiron t'ia dijë për nder dhe do të më kërkoj t'i bëjë ndonjë shërbim.	12	21%
Total	56	100%

Në pyetjen 3 shumica e prindërve 16 (29%) janë shprehur se fëmijët nuk janë ankuar për padrejtësi në notim, por ka edhe disa 12 (21%), që janë shprehur se ka padrejtësi në notim

të fëmijës së tyre, por qëllimisht nuk shkojnë të ankohen se mendojnë se mësimdhënësi do t'u kërkojë ndonjë shërbim. Disa prind 12 (21%), janë shprehur se e kanë kuptuar se mësimdhënësi nuk është i drejtë në notim ndaj djemve të tyre, kurse ndaj disa nxënësve të tjerë bën lëshime dhe se kanë shprehur opinionin e tyre se do të shkojnë të ankohen te drejtorja e shkollës.

Tabela 4-B. Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

4. Njëra nga lëndët mësimore për fëmijën tuaj është problem më vete, thjesht, "nuk i shkon". Një mik i juaj u thotë se e ka të afërt arsimtarin dhe në fund "do t'ia rregullojë" notën.	Frekuenca	%
Raste të tilla ka, por ato veprime nuk janë të mira dhe unë nuk e bëj një gjë të tillë.	25	45%
Jo kurrë nuk e lus ndonjë mik t'ia rregulloj notën fëmijës tim se në të ardhmen do të ketë problem me dituritë e tij.	18	32%
Po, disa herë detyrohem ta lus ndonjë mik, që të intervenojë te ndonjë arsimtar për t'ia rregulluar notën fëmijës tim.	13	23%
Total	56	100%

Në pyetjen 4 shumica e prindërve 25 (45%) janë shprehur se kurrë nuk intervenojnë për t'ia përmirësuar, notat fëmijës së vet, por disa prind 18 (32%) janë shprehur se kurrë nuk do të lusin ndonjë mik për t'ia përmirësuar notat fëmijës së tij se në të ardhmen do të ketë probleme me dituritë e tij, por ka edhe disa 13 (23%), që janë shprehur se ndonjëherë detyrohet ta lus ndonjë mik për t'ia përmirësuar notat fëmijës së tij, që të regjistrohet në shkollë të mesme.

Tabela 5-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

Fëmija juaj ju thotë se nuk është i përgatitur për testin e paralajmëruar, që është shumë i rëndësishëm për notën përfundimtare, prandaj Ju lutet t'i ndihmoni të bëjë fletëza me përgjigjet e sakta të disa pyetjeve për kopjuar si bëjnë shokët e tij.	Frekuenca	%
Jo, fëmijën tim nuk e lejoj të bëjë kopje, por i them të mësojë.	37	66%
Po, unë do t'i ndihmojë të bëjë kopje, pasi që shumica e nxënësve kopjojnë.	6	11%
Fëmija im nuk mëson rregullisht, por edhe kopje nuk përgatit.	13	23%
Total	56	100%

Në pyetjen 5 shumica e prindërve 37 (66%) janë shprehur se fëmijën nuk e lejon të bëjë kopje, por e detyron të mësojë, por disa prind 13 (23%) janë shprehur se do t'i ndihmojë të bëjë lista kopjuese se edhe në atë mënyrë mësohet, por 6 (11%) të prindërve janë shprehur se fëmija i tij vazhdimisht mëson dhe se nuk ka nevojë të bëjë kopje.

Tabela 6-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

Kujdestari i klasës u tregon detaje për gjendjen sociale familjare të një nxënësi dhe tregon disa karakteristika personale të fëmijës, duke e arsyetuar veten se pse ka intervenuar t'i përmirësohen notat e tij.	Frekuenca	%
Nuk e shoh të arsyeshme t'i përmirësohen notat fëmijës, për shkak të gjendjes sociale.	20	36%
Kujdestari nëse e sheh të arsyeshme se duhet t'ia përmirësojë notat ndonjë fëmije, që ka ndonjë problem familjar, atëherë është në rregull.	9	16%
Jo, kujdestari i klasës nuk duhet të bëjë një veprim të tillë.	13	23%
Ndihma për përmirësim e notave të një nxënësi me gjendje të vështirë sociale duhet të mbetet sekret në mesin e nxënësve dhe mësimeve.	14	25%
Total	56	100%

Në pyetjen 6 shumica e prindërve 29 (36%) janë shprehur se nuk e shohin të arsyeshme t'i përmirësohen notat dikujt, për shkak të gjendjes sociale, por disa prind 14 (25%) janë shprehur se kujdestari i klasës nëse e bën një veprim të tillë duhet ta mbajë sekret se atëherë demotivohen nxënësit tjerë, ndërsa disa prind 13 (23%) janë shprehur se kujdestari i klasës nuk duhet të bëjë një veprim të tillë, por disa prind 9 (16%) janë shprehur se nëse kujdestari e sheh të arsyeshme t'i ndihmojë ndonjë fëmije, që ka probleme familjare, atëherë në rregull është.

Tabela 7-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

7. Prindi i një fëmije të klasës së fëmijës suaj nëpër mbledhje prindërore ua merr pjesën më të madhe të kohës dhe nuk i pranon vlerësimet (notat), që arsimtarët ia kanë lënë fëmijës së tij.	Frekuenca	%
Prind të tillë ka, që vazhdimisht ankohen dhe revoltohen, kur te fëmija e tij nuk reflektohen nota të shkëlqyeshme dhe vazhdimisht e arsyeton fëmijën e vet se mëson rregullisht, kurse ankohet se arsimtarët e vlerësojnë me nota të dobëta.	8	14%
Prindi i tillë nuk ka të drejtë t'i kritikojë mësimeve, por duhet ta nxis fëmijën e tij të mësojë dhe notat t'i përmirësojë me meritë.	14	25%
Kjo nuk është në rregull, vetëm një prind të shfrytëzojë kohën e mbledhjes duke u ankuar për notat e dobëta të fëmijës së tij, se duhet edhe dikush tjetër të thotë diçka.	14	25%
Këto probleme duhet të bisedohen individualisht me kujdestarin e klasës.	20	36%
Total	56	100%

Në pyetjen 7 shumica e prindërve 20 (36%) janë shprehur se nuk e shohin të arsyeshme një prind vazhdimisht të ankohet dhe të revoltohet për suksesin e fëmijës së tij në mbledhje prindërore, por atë duhet ta shqyrtoj vetëm me kujdestarin e klasës, por ka disa prind 14 (25%) janë shprehur se prindi duhet ta nxis fëmijën të mësojë rregullisht, që notat t'i marrë me meritë.

Tabela 8-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

8. Një fëmijë me gjendje të rënduar sociale ka nota të dobëta në më shumë lëndë. Kujdestari i klasës i lut kolegët t'i japin nota më të larta sepse gjendja e atij nxënësi është vërtet e rëndë me shprehjen: " T'i ndihmojmë se është gjynah !".	Frekuenca	%
Kujdestari i klasës bën gabim nëse u bën kërkesë arsimtarëve të tjerë t'ia përmirësojnë notat një fëmije me gjendje sociale të vështirë, se kjo nuk është etike dhe nuk ka të bëjë me vlerësimin objektiv të arriturve të tij.	14	25%
Kujdestari ka të drejtë, një fëmije të tillë duhet t'i përmirësohen notat, por vetëm nëse i nevojitet notë kaluese e jo të barazohet me nxënësit e shkëlqyeshëm	24	43%
Mendoj se një fëmije të tillë duhet t'i ndihmohet materialisht ose financiarisht, e jo t'i përmirësohen notat.	9	16%
Nuk kam dëgjuar për raste të tilla.	9	16%
Total	56	100%

Në pyetjen 8 shumica e prindërve 24 (43%) janë shprehur se kujdestari ka të drejtë t'ia përmirësojë notat një nxënësi me gjendje të vështirë sociale të kolegët e tij, por të mos i barazojë notat me notat e nxënësve të shkëlqyeshëm. Disa prind 14 (25%) janë shprehur se kujdestari i klasës nëse e bën gabim se kjo nuk është etike, ndërsa disa prind 9 (16%) janë shprehur se një fëmije të tillë duhet t'i ndihmohet materialisht dhe financiarisht, por 9 (16%) të prindërve janë shprehur se nuk ka pasur rast të tillë.

Tabela 9-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

9. Kujdestari i klasës në mbledhje prindërore ankohet se disa prindër të disa nxënësve vazhdimisht gjatë orëve të mësimi, jashtë kohës së paraparë për bashkëpunim me prindër, u drejtohen arsimtarëve me ton të lartë, me fjalë ofenduese dhe kanosje.	Frekuenca	%
Kjo varet nga kultura e vet prindit, por edhe mësimdhënësi nuk duhet ta deklarojë një gjë të tillë para prindërve të tjerë, por duhet me prindin të bashkëpunojë për ta zgjidhur problemin dhe për ta bindur prindin se nuk ka të drejtë.	11	20%
Kjo gjë duhet të ndalohej, prindi duhet të ndjek ligjëratat e psikologu i shkollës.	9	16%
Prindi ta ofendojë ndonjë mësimdhënësin nuk është në rregull, por duhet të bisedojë për ta gjetur shkakun e revoltimit të tij , që të zgjidhet problemi në mënyrë të qetë.	12	21%
Raportet arsimtar prind çdoherë duhet të jenë në nivelin e duhur.	10	18%
Jo, kujdestari asnjëherë nuk është ankuar për raste të tilla.	14	25%
Total	56	100%

Në pyetjen 9 shumica e prindërve 14 (43%) janë shprehur se kujdestari asnjëherë nuk është ankuar për ndonjë rast të tillë. Disa prind 12 (21%) janë shprehur se një prind nuk ka të drejtë ta ofendojë mësimdhënësin, disa prind 11(20%) janë shprehur se mësimdhënësi nuk duhet të tregojë për një sjellje të tillë të ndonjë prindi, por duhet të mundohet ta bind prindin se nuk ka të drejtë, ndërsa disa prind 10 (18%) janë shprehur se raportet arsimtar-prind duhet të jenë në nivelin e duhur, ndërsa disa të tjerë 9 (16%)

janë shprehur se kjo sjellje duhet të ndalohet dhe prindi duhet të ndjek ligjërata të psikologu i shkollës.

Tabela 10-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

10. Fëmija juaj ankohet se arsimtari nuk ua tregon nxënësve shkakun për reflektimin e notave të dobëta, me të cilat nuk janë të kënaqur.	Frekuenca	%
Fëmijës nuk i besohet se ai në atë mënyrë e arsyeton veten se ka marrë notë të dobët, por përsëri duhet të bisedohet me mësimdhënësin e lëndës.	13	23%
Prindi duhet të shkojë te mësimdhënësi i lëndës dhe të kërkoj sqarime përse fëmija e tij ka marrë notë të dobët, ta shoh instrumentin vlerësues, testin.	10	18%
Mësimdhënësi duhet t'ua sqaroj nxënësve përse kanë nota të dobëta dhe t'u jep mundësi edhe njëherë të bëjnë test.	20	36%
Shumë mirë e ka bërë se shumica e nxënësve janë mësuar të marrin nota pa mësuar.	6	11%
Jo, fëmija im asnjëherë nuk është ankuar për raste të tilla.	7	12%
Total	56	100%

Në pyetjen 10 shumica e prindërve 20 (36%) janë shprehur se mësimdhënësi duhet t'ua sqarojë nxënësve shkakun e reflektimit të notave të dobëta dhe t'u jep mundësi edhe njëherë ta bëjnë testin, ndërsa disa prind 13 (23%) nëse fëmija ankohet se ka marrë notë të dobët, nuk duhet t'i besohet, por përsëri duhet të bisedohet me mësimdhënësin e lëndës, ndërsa disa prind 10 (18%) janë shprehur se prindi duhet të shkojë te mësimdhënësi të kërkoj sqarime dhe ta shoh instrumentin vlerësues-testin. Disa prind janë shprehur 7 (11%) se fëmija i tij asnjëherë nuk është ankuar për raste të tilla, ndërsa disa prind 6 (11%) i akuzojnë fëmijët e tyre se nuk kanë mësuar.

Tabela 11-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

11. Fëmija juaj ankohet se mësimdhënësi u shënon nota të dobëta atyre që nuk shkojnë në kurs.	Frekuenca	%
Problem të tillë nuk kemi pasur deri më sot.	14	25%
Nxënësi nëse ka mundësi ta paguaj kursin do të shkojë, por nëse nuk ka mundësi ta paguajë nuk do të shkojë. Mësimdhënësi është i obliguar nxënësit në shkollë t'i mësojë, e jo t'i detyrojë të marrin nota të dobëta dhe të shkojnë.	10	18%
Asnjë arsimtarë nuk ka të drejtë t'i detyrojë nxënësit të shkojnë në kurs duke u shënuar nota të dobëta nxënësve.	15	27%
Shumë gabim është nëse nxënësi kushtëzohet të merr notë të shkëlqyeshme duke e detyruar të shkojë në kurs për qëllim financiar përfitues të arsimtarit. (Mësimdhënësi i korruptuar)	17	30%
Total	56	100%

Në pyetjen 11 shumica e prindërve 14 (25%) janë shprehur se asnjë mësimdhënësi nuk i detyron fëmijët e tyre të shkojnë në kurs, ndërsa 15 (27%) prind janë shprehur se arsimtari nuk ka të drejtë t'i detyrojë nxënësit të shkojnë në kurs duke u shënuar nota të dobëta atyre, që nuk shkojnë. Disa prind 10 (18%) janë shprehur se mësimdhënësi është i obliguar t'i mësojë nxënësit në shkollë, e jo t'u shënojë nota të dobëta, që ata të

detyrohen të shkojnë në kurs. Disa prind 17 (30%) janë shprehur se është shumë gabim të detyrohen nxënësit të shkojnë në kurs për qëllim financiar përfitues të mësimdhënësit.

Tabela 12-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

12. Fëmija juaj ankohet se arsimtari nuk i nxit të bëjnë përsëritje para testit se ashtu më mirë i rikujtojnë parajohuritë.	Frekuenca	%
Përsëritja e materialit para testimit është e nevojshme se rikujtohen mësimet.	10	18%
Përsëritja u ndihmon nxënësve për të arritur rezultate më të mira, prandaj duhet të bëhet një orë para, që çfarë kanë të paqartë ta kuptojnë më mirë.	8	14%
Mësimdhënësi duhet t'u tregojë nxënësve dy orë para se do të kenë testim, por mendoj se nuk duhet të bëhet përsëritje një orë para testimit në klasë.	4	7%
Nuk e di se fëmija im nuk është ankuar asnjëherë.	16	29%
Çdo arsimtarë e ka metodën e vet të vlerësimit, dikush bën përsëritje para testimit e dikush jo se dëshiron t'i masë dijet e qëndrueshme të nxënësve.	18	32%
Total	56	100%

Në pyetjen 12 shumica e prindërve 18 (32%) janë shprehur se çdo mësimdhënësi e ka mënyrën e vet të vlerësimit, dikush bën përsëritje para testimit, kurse dikush qëllimisht nuk bën duke dashur t'i vlerësojë dijet e qëndrueshme të nxënësit. Disa prind janë shprehur 18 (32%) se fëmija i tyre nuk është ankuar asnjëherë. Disa prind 10 (18%) janë shprehur se përsëritja para testit ua rikujton nxënësve mësimet, ndërsa disa prind 8 (14%) janë të mendimit se përsëritja u ndihmon nxënësve t'i përforcojnë dituritë, disa prind 4 (7%) mendojnë se nxënësit duhet të jenë të njoftuar dy orë para se do të testohen dituritë e tyre, e jo të bëjnë përsëritje të materialit.

Tabela 13-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësin për prind-B

13. Fëmija juaj ankohet se arsimtari nuk u jep sqarime si ta plotësojnë testin.	Frekuenca	%
Mësimdhënësi nuk ka nevojë t'u jep sqarime shpesh nxënësve se ato janë të rritur.	16	29%
Mësimdhënësi duhet t'i orientojë fëmijët si ta plotësojnë testin.	22	39%
Mësimdhënësit çdoherë para se ta fillojnë ta plotësojnë testin, u japin sqarime nxënësve.	18	32%
Total	56	100%

Në pyetjen 13 shumica e prindërve 22 (39%) janë shprehur se çdo mësimdhënësi para se ta fillojë nxënësit plotësimin e testit duhet t'i orientojë nxënësit si ta plotësojnë testin, ndërsa disa 16 (29%) prind mendojnë se nuk ka nevojë mësimdhënësi t'u jep sqarime se janë të rritur më. Disa prind 18 (32%) janë shprehur se mësimdhënësit çdoherë para se ta fillojnë ta plotësojnë testin, u japin sqarime nxënësve.

Tabela 14-B: Opinione të ndryshme të shprehura në pyetësonin për prind-B

14. Fëmija juaj nuk i bën detyrat e shtëpisë rregullisht.	Frekuenca	%
Mësimdhënësi duhet ta informojë prindin, që ta nxis fëmijën t'i bëjë detyrat.	26	46%
Gabim, nxënësi e ka obligim t'i bëjë detyrat e shtëpisë në shtëpi.	20	36%
Po, fëmija im i bën detyrat rregullisht.	10	18%
Total	56	100%

Në pyetjen 14 shumica e prindërve 26 (46%) janë shprehur se mësimdhënësi duhet ta informojë prindin nëse fëmija e tij nuk i bën detyrat, ndërsa 20 (36%) janë shprehur se nxënësit e kanë obligim t'i bëjnë detyrat në shtëpi dhe disa prind të tjerë 10 (18%) krenohen me fëmijët e tyre se vazhdimisht i bëjnë detyrat.

Përfundime nga opinionet e reflektuara në pyetësonët e prindërve-Pytësoni-B

1. Dhurata për mësimdhënësin duhet të blihet nga buxheti i përbashkët i nxënësve, që asnjëri të mos ndjehet i privilegjuar në klasë
2. Në shkollë fillore mësimdhënësit kanë arritur një kulturë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi, por akoma ka ndonjë mësimdhënëse, që e konsideron veten si "Zot" në klasë, përdor fjalë ofenduese dhe ndonjëherë edhe ndonjë shuplakë ndaj nxënësve të padisiplinuar.
3. Prindërit mendojnë se vlerësimi është joobjektiv, prandaj do të ankohen te drejtoria e shkollës për mësimdhënësin, që në mënyrë joobjektive dhe joetikë i noton nxënësit.
4. Prindërit shprehen se nuk e shohin të arsyeshme të lusin ndonjë mësimdhënëse t'ia përmirësojë notën fëmijës së tij, por disa e arsyetojnë intervenimin për notë për shkak të arritjes së suksesit të shkëlqyeshëm, që në disa shkolla është kriter për regjistrim në shkollë të mesme.
5. Prindërit janë shprehur se fëmija nuk duhet të bëjë kopje para testimit të diturive të tij.
6. Prindërit nuk janë kundër përmirësimit të notave, që kujdestari t'ia bëjë një nxënësi me gjendje të vështirë sociale, por mendojnë se ajo të bëhet në fund të viti dhe të mbahet sekret se demotivohen nxënësit e shkëlqyeshëm, që vazhdimisht mësojnë.
7. Prindërit në mbledhje prindërore mund të flasin dhe të debatojnë kur do t'iu jepet fjala, e jo vetëm njëri vazhdimisht të ankohet për suksesin e dobët të reflektuar të fëmijës së tij
8. Të gjithë prindërit janë shprehur se duhet t'i ndihmohet një nxënësi me gjendje sociale të vështirë, por notat nuk duhet të barazohen me notat e nxënësve të shkëlqyeshëm.
9. Në bazë të opinionëve të shprehura të prindërve vërehet se të gjithë prindërit e din se raportet mësimdhënëse-prind duhet të sqarohen me mirëkuptim e jo me sjellje agresive.
10. Në bazë të opinionëve të shprehura të prindërve vërehet se të gjithë prindërit e din se reflektimi i notave të dobëta është edhe rezultat i punës së mësimdhënësit,

prandaj duhet të sqarohen paqartësitë dhe nëse ka nevojë të zhvillohen disa njësi mësimore edhe njëherë.

11. Prindërit e kundërshtojnë sjelljen e çdo mësimdhënësit, që u shënon nota të dobëta nxënësve për t'i detyruar nxënësit të shkojnë në kurs.
12. Prindërit e dinë se përsëritja e mësimave para se të bëhet testimi u ndihmon nxënësve t'i largojnë paqartësitë dhe t'i përforcojnë dijet.
13. Prindërit janë të kënaqur nga puna e mësimdhënësit cilët shprehin gatishmëri për t'u dhënë nxënësve sqarime shtesë.
14. Shumica e prindërve krenohen me fëmijët e tyre se vazhdimisht i bëjnë detyrat.

Pyetësi C - Pyetësor për nxënës

Nxënës i nderuar,

Në këtë pyetësor janë dhënë disa mendime, por ka të parashtrura edhe disa pyetje të hapura për t'i shprehur edhe Ju disa mendime në lidhje me vlerësimin e të arriturave të nxënësve.

Ju lutem përgjigjuni me sinqeritet në hapësirën poshtë!

Ju falënderoj për kohën që e ndatë për ta plotësuar këtë pyetësor!

25.01.2023, Gostivar

Tabela 1-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësin për nxënës-C

1. Disa nxënës shpesh u sjellin disa arsimtarëve dhuratat? Po Ju si veproni?	Frekuenca	%
Në klasën tonë të gjithë nxënësit japin të holla për t'i blerë mësimdhënësit kujdestar dhuratë, që ia dhurojmë për 7 Mars, por ndonjëherë edhe për ditëlindje. Ndonjëherë i dhurojmë dhuratë edhe ndonjë arsimtari tjetër, që e vërejmë se i pëlqen dhuratat.	30	53%
Po në raste të veçanta, kur kthehem nga ndonjë shëtitje se më lejoj të shkoj.	10	18%
Jo, unë nuk i dhuroj asnjë mësimdhënësi dhuratë se ai merr pagë.	8	14%
Jo, unë nuk i dhuroj asnjë mësimdhënësi dhuratë se mendoj se dhuratat më e madhe për mësimdhënësin është reflektimi i suksesit të nxënësit në të mësuarit.	1	2%
Unë i dhuroj dhuratë atij mësimdhënësi, që i pranon dhuratat e nxënësve.	5	9%
Po ndonjëherë është mirë t'ju dhurojmë mësimdhënësit dhuratat se ata na mësojnë. Dhuratat është falënderim dhe respekt ndaj punës së tij.	2	4%
Total	56	100%

Në pyetjen 1 në përshtatshmëri me opinionin e dhënë shumica e nxënësve 30 (53%) reflektuan opinione pozitive për vlerësimin e punës së mësimdhënësit të tyre, prandaj si shenjë respekti dhe falënderimi u dhurojnë dhuratat për festën e 7 Marsit –Ditën e Mësuesit Shqiptar. Disa nxënës 8 (14%) janë shprehur negativisht për dhënien e dhuratave mësimdhënësit me arsyetim se çdo mësimdhënësi merr pagë për punën e vet dhe nuk ka nevojë t'i dhurohet ndonjë dhuratë.

Tabela 2-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësonin për nxënës-C

2. E vëreni se një nxënës mungon shpesh, kur ka test ose përsëritje për notë, por për arsyetim sjellë vërtetim se ka qenë i sëmure. Po Ju si veproni?	Frekuenca 56 nxënës	%
Ndonjë nxënës e bën këtë gjë qëllimisht, mungon ditën e testimit duke u arsyetuar se është i sëmure, mirëpo kur kthehet në mësim përsëri nuk e bën testin, kurse në fund të gjysmëvjetorit nota i përmirësohet.	20	36%
Me këtë çështje duhet të merret mësimdhënësi, ta detyrojë nxënësin një ditë tjetër të plotësojë testin.	8	14%
Jo, unë mundohem vazhdimisht të jem në klasë kur bëhet testimi dhe një gjë e tillë nuk më ka ndodhur, por as shokëve të mi.	17	30%
Unë mungoj vetëm kur jam shumë i sëmure, por orën e testimit të vij ta bëj testin.	10	18%
Kjo është çështje individuale në mes tij, prindërve dhe mësimdhënësit.	1	2%
Total	56	100%

Në pyetjen 2 disa nxënës 20 (36%) shprehen se disa nxënës atë ditë kur ka testim nuk vijnë në shkollë bëhen se janë të sëmure, kurse në fund të vitit nota i përmirësohet. Disa nxënës 17 (30%) shprehen se ata vazhdimisht kanë qenë të pranishëm në klasë gjatë realizimit të çdo testimi. Disa nxënës 10 (18%) thonë se nëse janë të sëmure atë ditë orën e testimit vinë në klasë për ta plotësuar testin.

Tabela 3-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësonin për nxënës-C

3. Shpesh disa nxënës kërkojnë t'u përshpërisim kur ata përgjigjen. Po Ju si veproni kur përgjigjeni a prisni t'u përshpëris dikush?	Frekuenca	%
Po edhe në klasën tona bëhen veprime të tilla, disa nxënës kërkojnë t'ua përshpërisim përgjigjen e saktë, kur ata përgjigjen.	22	39%
Nëse kam mundësi u ndihmojë shokëve, që përgjigjen për notë.	3	5%
Nuk e bëj një gjë të por e lejoj shokun ta thotë atë që e dinë.	16	29%
Unë asnjëherë nuk kërkoj nga ndonjë nxënës të m'i përshpërisë përgjigjet, por edhe unë nuk ia përshpërisë përgjigjet ndonjë shoku.	11	20%
Ndonjëherë t'ia rikujtohem ndonjë përgjigje ndonjë shoku nuk është keq, por i ndihmon ta rikujtojë mësimin.	4	7%
Total	56	100%

Në pyetjen 3 disa nxënës 22 (39%) shprehen se në klasë ka shokë, që ua përshpërisin përgjigjet nxënësve, që nuk dinë, kurse 14 (25%) nxënës shprehen se asnjëherë nuk ia përshpërisin përgjigjen e saktë shokut se qortohen nga mësimdhënësi, ndërsa 11 (20%) nxënës janë shprehur se asnjëherë nuk kërkojnë nga shokët t'ua përshpërisin përgjigjet e sakta, por edhe vet nuk ua përshpërisin nxënësve përgjigjet e sakta, por 4 (7%) nxënës janë shprehur se ndonjëherë t'ia rikujtohem ndonjë përgjigje shokut nuk është keq se ia rikujton mësimin. Disa nxënës 3 (5%) janë shprehur se nëse ka mundësi u ndihmon shokëve kur ata përgjigjen për notë.

Tabela 4-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësonin për nxënës-C

4. Disa nxënës nuk i bëjnë detyrat e shtëpisë në shtëpi, por gjatë pushimit të madh i përshkruajnë nga nxënësit tjerë.	Frekuenca	%
Disa nxënës detyrat e shtëpisë i bëjnë në klasë.	26	46%
Në klasën tonë shumica e nxënësve detyrat e shtëpisë i bëjnë në shtëpi.	20	36%
Unë detyrat i bëj vazhdimisht në shtëpi, por disa i kopjojnë detyrat nga unë në klasë.	10	18%
Total	56	100%

Në pyetjen 4 disa nxënës 26 (46%) janë shprehur se detyrat e shtëpisë i bëjnë në klasë, kurse disa 20 (36%) janë shprehur se detyrat e shtëpisë i bëjnë në shtëpi, kurse disa 10 (18%) janë shprehur se detyrat i bëjnë vazhdimisht në shtëpi.

Tabela 5-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësonin për nxënës-C

5. Një nxënës vazhdimisht gjatë testimit në lëndën e matematikës, por edhe te lëndët tjera, përgatit fletëza dhe kopjon, edhe pse e din se kjo nuk është e lejuar. Po Ju si veproni?	Frekuenca 56 nxënës	%
Në klasën tonë disa nxënës e praktikojnë kopjimin nga fletëzat.	14	25%
Unë nuk përgatis fletëza të tilla se dua ta marrë notën me meritë.	13	23%
Jo unë nuk e bëj se nëse ma gjen mësimdhënësi fletëzën mund të marrë notë të dobët. Kopjimi nuk është veprim i mirë.	11	20%
Jo unë nuk e bëj se më mirë kohën ta shfrytëzoj për të mësuar e përsëritur materialin sesa të bëj fletëza për kopjim.	8	14%
Jo nuk e kam vërejtur, pasi që kam qenë duke e plotësuar e testin.	2	4%
Po e kam vërejtur se disa nxënës kopjojnë dhe marrin nota të mira.	8	14%
Total	56	100%

Në pyetjen 5 janë shprehur 14 (25%) nxënës se përgatisin fletëza kopjimi për të marrë nota më të mira se nuk janë të sigurt në dituritë e veta, ndërsa 13 (23%) nxënës kopjimin e konsiderojnë si humbje kohe dhe joetike, kurse 11 (20%) e din se kopjimi nuk është veprim i mirë dhe kanë frikë të mos ua gjen mësimdhënësi se do të marrin notë të dobët, ndërsa 8 (14%) nxënës mendojnë se e humbin kohën nëse përgatisin fletëza kopjuese, mirëpo 8 (14%) nxënës e kanë vërejtur se disa nxënës marrin nota të mira duke kopjuar.

Tabela 6-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësonin për nxënës-C

6. Disa nxënës marrin informata nga nxënës të klasave të tjera për pyetjet e testit, ashtu që marrin nota më të mira se ato që nuk interesohen.	Frekuenca	%
Po, marrin informata nga nxënës të klasave të tjera për pyetjet e testit, nëse ata kanë pasur test një orë para nesh.	26	46%
Unë nuk bëj një gjë të tillë se jam përgatitur në shtëpi.	30	54%
Total	56	100%

Në pyetjen 6 disa nxënës 26 (46%) janë shprehur se marrin informata nga nxënës të klasave të tjera për pyetjet e testit, ashtu që marrin nota më të mira, por shumica përgatiten në shtëpi.

Tabela 7-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësonin për nxënës-C

7. Disa nxënës shpesh marrin të mësojnë në fund të gjysmëvjetorit ose në fund të vitit edhe pse e dinë se duhet të mësojnë rregullisht.	Frekuenca	%
Unë mësojë vazhdimisht se dëshiroj të arrijë diçka në jetë, nuk mësojë vetëm për notë.	18	32%
Unë mendoj se është lodhje psikike, t'i mësosh të gjithë mësimet vetëm para gjysmëvjetorit, prandaj mësojë vazhdimisht.	13	23%
Po është e vërtetë, disa nxënës mësojnë vetëm para gjysmëvjetorit vetëm për të marrë një notë të mirë se janë nota përmbyllëse.	20	36%
Unë mendoj se mirë është të mësosh edhe në fund të gjysmëvjetorit ose fund të vitit shkollor sesa kurrë të mos mësosh.	5	9%
Total	56	100%

Në pyetjen 7 nxënësit janë shprehur në disa opsione, ku 20 (36%) nxënës janë shprehur se mësojnë vetëm kur bëhet vlerësimi sumativ për të marrë notë të mirë, ndërsa 18 (32%) nxënës shprehen se mësojnë vazhdimisht për t'i arritur notat e shkëlqyeshme me meritë, ndërsa 13 (23%) janë shprehur se të mësuarit permanent nuk shkakton lodhje psikike, kurse 5 (9%) nxënës janë shprehur se më mirë është të mësosh edhe në fund të vitit sesa kurrë të mos mësosh.

Tabela 8-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësonin për nxënës-C

8. Një nxënës i ka përmirësuar notat vetë në ditar për ta fshehur suksesin e dobët të tij dhe për të pasur sukses më të mirë.	Frekuenca	%
Në klasën tonë nuk ka pasur nxënës të tillë.	37	66%
Ky veprim është shumë i keq dhe duhet të merren masa ndëshkuese.	8	14%
Kurrë nuk do të kisha bërë një veprim të tillë se është jashtë çdo norme	11	20%
Total	56	100%

Në pyetjen 8 nxënësit janë shprehur në të tri opsionet, ku 37 (66%) nxënës dhe 11 (20%) e dinë se përmirësimi i notave nga ana e tyre në e-ditar është veprim shumë i keq dhe kurrë nuk do ta kishin bërë një veprim të tillë manipulues, i cili duhet ndëshkuar.

Tabela 9-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësonin për nxënës-C

9. Disa nxënës, kur arsimtari e cakton ditën e mbajtjes së testit, ankohen, kërkojnë shkak, që testi të anulohet për një ditë tjetër. Disa nxënës kërkojnë të mos u parashtrohen pyetje të rënda, që më lehtë të marrin nota të shkëlqyeshme.	Frekuenca	%
Nxënësit, që nuk mësojnë rregullisht ankohen dhe duan ta anulojnë testimin, që të mbahet një ditë tjetër se mund të marrin nota të dobëta.	18	32%
Ky veprim nuk është i mirë, t'i kërkojnë mësimdhënësit ta anulojë testimit.	14	25%
Unë nuk bëj kërkesa të tilla, por e bëj testin në ditën e përcaktuar.	15	27%
Ka ndodhur të kërkojmë ta anulojnë testimin se atë ditë kemi pasur edhe testime edhe të lëndët tjera.	9	16%
Total	56	100%

Në pyetjen 9 nxënësit janë shprehur në katër opsionet, 18 (32%) të nxënësve janë shprehur se nxënësve duhet t'u jepet një mundësi për ta anuluar testimin nëse nuk kanë mësuar për ditën e përcaktuar të testimit, kurse 14 (25%) kërkesën për anulimin e testimit e konsiderojnë si veprim të keq, kurse 15(27%) se testin e bëjnë atë ditë kur është testimi, kurse 9(16%), e arsyetojnë anulimin e testimit nëse të ditë kanë më tepër teste në lëndë të ndryshme.

Tabela 10-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësonin për nxënës-C

10. Disa nxënës kanë mësuar pak gjatë tërë vitit, ndërsa në fund kërkojnë nga arsimtarët t'u japin notë të shkëlqyeshme për t'u regjistruar në shkollën e mesme, që ata e dëshirojnë.	Frekuenca	%
Kjo ndodh vazhdimisht kur shënohen notat në ditar.	21	37%
Ky veprim është i padrejtë ndaj nxënësve që vazhdimisht mësojnë se nuk duhet të barazohen notat e nxënësve shembullorë me notat e nxënësve, që nuk mësojnë.	18	32%
Mua nuk më pengon aspak nëse mësimdhënësi dikujt ia fal notën për t'u regjistruar më lehtë në shkollë të mesme.	2	4%
Përmirësimi i notave pa meritë është i dëmshëm për të gjithë nxënësit.	13	23%
Unë mendoj se më rëndësi është dituria e jo nota.	2	4%
Total	56	100%

Në pyetjen 10 nxënësit janë shprehur në katër opsionet, ku 21 (37%) janë shprehur se në fund të vitit çdoherë nga nxënësit kërkohet t'u rriten notat, ndërsa 18 (32%) janë shprehur se nuk duhet të barazohen notat e nxënësve shembullorë me notat e nxënësve që nuk mësojnë, kurse 13(23%) janë shprehur se përmirësimi i notave pa meritë i disa nxënësve është shumë i dëmshëm për të gjithë nxënësit, ndërsa 2 (4%) nxënës janë shprehur se aspak nuk u pengon aspak nëse mësimdhënësi ia rrit nxënësit atij nxënësi, që nuk mëson se i nevojitet për t'u regjistruar në shkollë të mesme dhe 2 (4%) nxënës janë të bindur se më me rëndësi është dija e jo nota.

Tabela 11-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësin për nxënës-C

11. Disa nxënës nuk vijnë në mësim plotësues, edhe pse notat i kanë të dobëta, pastaj kërkojnë nota t'u përmirësohet.	Frekuenca	%
Mësimi plotësues të ne nuk mbahet se nxënësit çdo ditë kanë nga 7 orë dhe nuk duan të shkojnë, por në fund të vitit rritja e notës bëhet.	32	57%
Kujdestari në këtë rast nuk duhet t'u ndihmojë këtyre nxënësve me rritjen notës, por edhe vet mësimdhënësi lëndor.	14	25%
Mësimi plotësues duhet të ndiqet nga nxënësit e dobët se u ndihmon për të mësuar.	10	18%
Total	56	100%

Në pyetjen 11 në opsionin e parë janë shprehur 32 (57%) nxënës se mësimi plotësues në shkolla nuk mbahet por edhe duhet të ndiqet nga nxënësit e dobët se atyre u nevojitet.

Tabela 12-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësin për nxënës-C

12. Ju keni notë të dobët në një lëndë, kurse mësimdhënësi juaj mban kurse private dhe ju informon si do të veproni ju a do të shkoni në kurs ose jo?	Frekuenca	%
Problem të tillë nuk kam pasur deri më sot.	14	25%
Nëse na informon mësimdhënësi se mban kurse private me siguri do të shkoj, por nëse informatën e bën dikush tjetër , atëherë do të zgjedh, cili është në çmim me i lirë.	10	18%
Nëse nuk shkoj në kurs me siguri do të marrë notë të dobët .	15	27%
Nëse shkoj në kurs me siguri do të marrë notë të shkëlqyeshme se mësimdhënësi i lëndës do të na e ushtrojë testin, që do të mbahet. (Mësimdhënësi i korruptuar)	17	30%
Total	56	100%

Në pyetjen 12 në opsionin e parë janë shprehur 14 (25%) nxënës se problem me mbajtjen e kurseve nga mësimdhënësi lëndor nuk kanë pasur, kurse 10 (18%) nxënës janë shprehur se nëse mësimdhënësi i lëndës i informon se mban kurse private atëherë ato do ta ndjekin kursin tek ai, por nëse u ofrohet informata nga dikush jashtë institucionit atëherë do ta zgjedhin ta ndjekin atë kurs, që është më i lirë në çmim, ndërsa 15 (27%) janë shpreur se nëse nuk shkojnë në kurs me siguri do të marrin nota të dobëta në atë lëndë, kurse 17 (27%) janë shprehur se nëse shkojnë në kurs me siguri do të marrin nota të shkëlqyeshme se mësimdhënësi i lëndës do t'ua ushtrojë testin, që do të mbahet.

Tabela 13-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësin për nxënës-C

13. Nxënësit ankohen se arsimtari i një lënde para se ta bëjë testimin nuk bën përsëritje me nxënësit për t'i përforcuar dituritë e tyre për materialin e zhvilluar Si do të veproni Ju ?	Frekuenca	%
Ne çdoherë një orë para testimit bëjmë përsëritje të materialit për t'i rikujtuar mësimet.	26	46%
Ne asnjëherë nuk bëjmë përsëritje në klasë një orë para testimit, por mësojmë vet në shtëpi.	30	54%
Total	56	100%

Në pyetjen 13 janë shprehur 26 (46%) nxënës se çdoherë para zbatimi të testimit bëhet përsëritje të materialit mësimor në klasë, ndërsa 30 (54%) nxënës janë shprehur se bëhet përsëritje në klasë para testimit, por çdonjëri përsërit vet në shtëpi.

Tabela 14-C: Situata të ndryshme të paraqitura në pyetësorin për nxënës-C

14. Disa nxënës ankohen se mësimdhënësi para se ta realizojë testimin nuk i orienton nxënësit për plotësimin e testit, prandaj disa nga nxënësit e plotësojnë testin, por disa jo.	Frekuenca	%
Neve na nevojitet sqarim orientues për plotësimin e testit, por mësimdhënësit refuzojnë të na japin sqarime, ndoshta ky është edhe shkak se disa nxënës e plotësojnë testin, kurse disa jo.	28	50%
Në fillim të testit janë të shënuara kriteret e vlerësimit, prandaj nuk ka nevojë shtesë të jepen sqarime se vetëm duhet të lexohen.	11	20%
Mësimdhënësit çdoherë para testimit na japin sqarime për plotësimin e testit.	17	30%
Total		100%

Në pyetjen 14 nxënës janë shprehur në tre opsionet, ku 28 (50%) nxënës janë shprehur se mësimdhënësit refuzojnë t'u ofrojnë në fillim të orës sqarim orientues për plotësimin e testit, kurse 11 (20%) nxënës janë shprehur se nuk ka nevojë të ofrohet sqarim orientues për plotësimin e testit se në test janë të shënuara kriteret, kurse 17 (30%) nxënës janë shprehur se mësimdhënësit çdoherë u japin sqarime orientuese në fillim të orës së testimit.

Përfundime nga opinionet e reflektuara në pyetësorët e nxënësve-Pyetësori-C

- 1) Shumica e nxënësve reflektuan opinione pozitive për dhënien e dhuratës mësimdhënësit kujdestarë për Ditën e Mësuesit, por ka edhe të tillë që reflektuan opinione negative me arsyetim se çdo mësimdhënëës merr pagë për punën e vet.
- 2) Nxënësit e kanë kuptuar se testimi është pjesë e pandarë e procesit mësimor, kurse disa nxënës atë ditë, kur bëhet testim sëmuhen, kurse në fund të vitit nota i përmirësohet.
- 3) Nxënësit kanë krijuar kulturë respektimi gjatë procesit të vlerësimit, ashtu që e kanë kuptuar se duhet të mos pëshpërisin, por ndonjëherë mund të ndodh.
- 4) Nxënësit kanë arritur kulturë përgjegjshmërie ndaj përgjegjësisë si nxënës, prandaj detyrat e shtëpisë i kryejnë në kohë.
- 5) Shumica e nxënësve kopjimin e konsiderojnë si humbje kohe dhe veprim jo etikë, ndërsa ka edhe të tillë që e konsiderojnë si mjet ndihmës për testim.
- 6) Disa nxënës marrin informata nga nxënës të klasave të tjera për pyetjet e testit, ashtu që marrin nota më të mira, por shumica përgatiten në shtëpi.
- 7) Shumica e nxënësve mësojnë në vazhdimësi për t'i arritur notat e shkëlqyeshme me meritë, ndërsa disa nxënës mësojnë vetëm para se të bëhet vlerësimi sumativ.
- 8) Nxënësit e dinë se përmirësimi i notave nga ana e tyre në e-ditar është veprim shumë i keq, prandaj kurrë nuk do ta kishin bërë një veprim të tillë manipulues.
- 9) Nxënësit janë shprehur se duhet t'u jepet një mundësi për ta anuluar testimin nëse nuk kanë mësuar atë ditë se atë ditë kanë më tepër teste në lëndë të ndryshme.

- 10) Nxënësit janë mësuar me barazimin e notave të nxënësve në fund të vitit dhe janë shprehur se aspak nuk u pengon nëse mësimdhënësi ia rrit notën nxënësit, që nuk mëson se i nevojitet për t'u regjistruar në shkollë të mesme.
- 11) Shumica e nxënësve janë shprehur se mësimi plotësues në shkollë nuk mbahet, por në fund të vitit nota u rritet nxënësve të dobët në mësim.
- 12) Disa nxënës janë shprehur se problem me mbajtjen e kurseve nga mësimdhënësi lëndor nuk kanë pasur, por nëse mësimdhënësi i ndonjë lënde i njofton se mban kurse private atëherë ato do ta ndjekin kursin tek ai, që iu jep mësim sesa te dikush tjetër.
- 13) Nxënësit tregojnë se një orë para testimit çdoherë në klasë bëjnë përsëritja të materialit mësimor të zhvilluar, kurse disa e mohojnë, por tregojnë se përsërisin vetë në shtëpi.
- 14) Disa nxënës janë shprehur se mësimdhënësit refuzojnë t'u ofrojnë në fillim të orës sqarime orientuese për plotësimin e testit, kurse disa nxënës janë shprehur se nuk ka nevojë të ofrohet sqarim orientues pasi që në test janë të shënuara kriteret.

Përfundime nga Pyetësi –D i zhvilluar me nxënësit e njëjtë, por në klasën e VIII-IX

Ky anketim u zhvillua me të njëjtit nxënës, që u anketuan më 2023, por edhe si nxënës të klasës së VIII-IX më 2024 dhe 2025 me pyetësin në vijim për ta ndjekur aktivitetin e tyre jashtëmësimit gjatë ditëve të punës mësimore dhe gjatë vikendit, kur nxënësit duhet të pushojnë.

Pyetje dhe përgjigjet	Diskutimi i rezultateve
1. Ju lutemi shënoni sa kurse ndiqni gjatë javës dhe shënoni për cilën lëndë e ndiqni atë kurs? - Një kurs: <u>informatikë, 1(2%) nxënës</u> - Dy kurse: <u>matematikë, fizikë 52 (93%) nxënës.</u> - Tri kurse: <u>matematikë, fizikë, gjuhë angleze (1(2%) nxënës)</u> - Më tepër: <u>matematikë, fizikë, art dhe matematikë, fizikë, gjuhë maqedonase, informatikë (2(4%) nxënës)</u>	Në mbështetje të përgjigjeve të nxënësve shumica e nxënësve 52 (93%) ndjekin dy kurse gjatë javës në lëndën e matematikës dhe fizikës, kurse vetëm një është shprehur se e ndjek edhe kursin e informatikës dhe një nxënës vetëm gjuhës angleze, ndërsa ka edhe të tillë që shkojnë në katër kurse të ndryshme për t'i zgjeruar dijet individuale.
2. Ju lutemi shënoni te cili mësimdhënësi e ndiqni kursin! - Te mësimdhënësi i që na jep mësim në shkollë <u>54 (96%) nxënës</u> - Te një mësimdhënësi tjetër. <u>2 (4%) nxënës</u>	Në pyetjen e dytë 54 nxënës janë përgjigjur se shkojnë te mësimdhënësi, që ju jep mësim për ta siguruar notën e shkëlqyeshme, kurse dy shkojnë te mësimdhënësi tjetër.
1. Sa here gjatë javës shkoni në kurs ? - Dy herë gjatë javës 54 (96%) <u>nxënës</u> - Një herë gjatë javës 2 (4%) <u>nxënës</u>	54 nxënës janë shprehur se kursin e ndjekin dy herë gjatë javës, kurse dy nxënës janë shprehur se shkojnë një here, por në kurse të ndryshme të shtunën.
2. A mbani orë shtuese dhe plotësuese në shkollë? - Jo 56 (100 %) <u>nxënës</u> - Po	Orët shtuese dhe plotësuese nuk mbahen në shkollë janë shprehur 56.
3. Hapësirën për mbajtjen e kursit kush e përcakton? Mësimdhënësi 56 (100 %) <u>nxënës</u>	Hapësirën ku mbahet kursi e përcakton mësimdhënësi janë shprehur 56 nxënës.

Merita Banjica
KRITERI I NOTËS MESATARE “SUKSES I SHKËLQYESHËM” NDIKON
NË VLERËSIMIN JOETIKË TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE NË SHKOLLA FILLORE

• Unë	
4. Shënoni ditën kur shkoni në kurs gjatë javës? • E hënë • E martë 56 (100 %) <u>nxënës</u> në fizikë, në matematikë dhe 1 (2%) në informatikë • E mërkurë • E enjte • E premte 56 (100 %) <u>nxënës</u> në matematikë • E shtunë 56 (100 %) <u>nxënës</u> në fizikë dhe 1(2%) <u>nxënës</u> edhe gj. angleze	Gjatë javës kurset i ndjekin gati çdo të dytën dhe janë të angazhuar në kurse të ndryshme, të marten, të premten, ndërsa ka edhe të tillë që e ndjekin kursin edhe gjatë vikendit.
5. A ju nxit dikush të shkoni në kurs? • Kur mësimdhënësi më thotë: “nuk din asgjë” 30 (53%) <u>nxënës</u> • Kurreshtja për të mësuar më tepër 26 (46%) <u>nxënës</u> • Kurreshtja për ta parë testin. 56 (100 %) <u>nxënës</u> • Për ta siguruar notën e shkëlqyeshme <u>56 (100%) nxënës</u>	Ndjekjen e kursit nxënësit e arsyetojnë se janë të bindur se duhet të shkojnë në kurs se vazhdimisht mësimdhënësi u thotë “Asgjë nuk din”, por ka edhe të tillë që janë kurreshtar për të mësuar më tepër. për ta parë testin dhe për ta siguruar notën.
6. Përse ata dy orë, që i kaloni në kurs nuk i përdorni për t’i mësuar mësimet në shtëpi? • Në shtëpi nuk ka kush të m’i sqarojë mësimet e pakuptuara 2 (4 %) <u>nxënës</u> • Nëse nuk shkoj nuk mund ta shoh testin 54 (96%) <u>nxënës</u> • Nëse nuk shkoj nuk mund të marrë notë të shkëlqyeshme 54 (96%) <u>nxënës</u>	Nxënësit janë shprehur se shkojnë në kurs me qëllim për ta parë testin dhe për ta siguruar notën e shkëlqyeshme të këto lëndë shkenore, por ka edhe të tillë që duan t’i zhvillojnë shkathtësitë e plurilingualizmit, që më mirë të komunikojnë edhe në gjuhën angleze se është gjuhë më e dëshirueshme e shekullit XXI dhe për t’i zhvilluar shkathtësitë e pikturimit dhe shkathtësitë e digjitalizimit.

Përfundimet e përgjithësuara nga katër pyetëtorët e përdorur në këtë hulumtim.

Aspekti pedagogjik modernizimin e mësimdhënësit e sheh si nevojë të domosdoshme për ta zhvilluar personalitetin e mësimdhënësit, që të ndikojë zhvillimin e personalitetit të nxënësit, të cilit institucionet arsimore ia kanë siguruar zhvillimin gradual të arsimimit për zhvillimin e personalitetit të nxënësit edhe atë, prej klasës I-IX në shkollë fillore, pastaj ky arsimim vazhdon në shkollë të mesme prej vitit të I-IV.

Këto fëmijë janë brezi i katërt ose i pestë, që arsimohen, ashtu që edhe prindërit e tyre janë të arsimuar dhe arsimdashës, prandaj fëmijët e tyre i angazhojnë në kurse edhe pse dy vite më parë, kur fëmijët e tyre ishin klasë e shtatë, e shprehën një qëndrim negativ për ndjekjen e kurseve. Shprehja e qëndrimit pozitiv të për ndjekjen e kurseve të fëmijëve të tyre, ku janë nxënës në klasë të VIII dhe IX vjen nga frika, që te suksesi i fëmijëve të tyre në fund të vitit të mosreflektohen nota të dobëta, por të reflektohen nota të shkëlqyeshme.

Aspekti psikologjik “Të mësuarit gjatë gjithë jetës” e sheh si një process të dosdoshëm, që në vazhdimësi i nevojitet qytetarit të shekullit XXI, ashtu që nxënësit e shkollës fillore nuk ka nevojë të ndjekin aq shumë kurse se mësimdhënia nuk u duket interesante në klasë, nxënësit demotivohen për të pranuar njohuri të reja në klasë pa

pagesë duke menduar se mund t'i zhvillojnë ato në kurse private me pagesë, ashtu që bëhen edhe të padisiplinuar gjatë orëve mësimore dhe manipulues për ta arritur notën e shkëlqyeshme duke e pare testin në kurse me pagesë.

Përgjithësimet e përfundimeve të katër pyetësorëve i paraqesim në vijim:

- Mësimdhënësve u pëlqejnë dhuratat, që nxënësit ua sjellin në shenjë mirënjohjeje për ndonjë festë, por dhurata duhet jetë simbolike dhe e lirë nga buxheti i përbashkët i të gjithë nxënësve, që asnjëri të mos ndjehet i privilegjuar në klasë.
- Nxënësit kanë arritur kulturë vlerësimi, ashtu që edhe nëse janë të sëmure vinë të testohen.
- Nxënësit kanë arritur kulturë vlerësimi, prandaj edhe nuk përshtetësin në klasë.
- Nxënësit kanë arritur shprehi pune, prandaj në kohë i bëjnë detyrat e shtëpisë.
- Fletëzat e kopjimit shumë pak përdoren nga nxënësit.
- Demotivimi i nxënësve të shkëlqyeshëm për të mësuarit në vazhdimësi ndodh për shkak se nota i barazohet me notën e një nxënësi të dobët dhe të painteresuar për mësim si veprim human ndaj gjendjes sociale të vështirë të tij.
- Kërkesa për notë mesatare më të lartë për pranim në shkollë të mesme është shkak i moszbatimit të vlerësimit etik dhe objektiv për të arriturat e nxënësve në shkolla fillore.
- Mësimdhënësit nuk duhet t'i barazojnë notat e nxënësve, që nuk mësojnë tërë vitin për t'u regjistruar në shkollë të mesme me notat e nxënësve të shkëlqyeshëm, që mësojnë.
- Ndjekja e kursit të mësimdhënësi-ligjërues i lëndës duhet të ndalohej, por mund të ndiqet te mësimdhënësi tjetër sipas nevojës për zgjerim të njohurive të fëmijës.
- Në e-ditar notat nuk mund të përmirësohen nga askush tjetër, përveç nga mësimdhënësi i lëndës, i cili ndonjëherë mund të bëjë gabim në të shënuarit e notës ose të bëjë përmirësim.
- Nxënësve duhet t'u jepet një mundësi për ta anuluar testimin nëse kanë pasur testim tjetër.
- Mësimi plotësues dhe shtues të mbahet në shkollë, e jo të nxiten nxënësit të shkojnë në kurs.
- Çdoherë një orë para testimit në klasë duhet të bëhet përsëritja të materialit mësimor.
- Mësimdhënësit në fillim të testit duhet t'u japin sqarime nxënësve për plotësimin e testit.

5. Rekomandime

Ky hulumtim i zhvilluar me mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit të një shkolle fillore ndriçoi rezultatet e pritura, që e mbështesin hipotezën e përgjithshme të përcaktuar për këtë hulumtim:

- Përmbushja e kriterit “sukses të shkëlqyeshëm” për regjistrim në shkollë të mesme medicinale bëhet arsyeja kryesore për vlerësimin joetik së të arriturave të nxënësve në shkolla fillore.

Rekomandimet u formuluan në mbështetje të hipotezave ndihmëse dhe rezultateve të hulumtimit:

- Vlerësimi joetik dhe joobjektiv i të arriturave të nxënësve nuk duhet të vazhdohet, por të ndërpriten edhe plotësimi i kërkesave të subjekteve të ndryshme për rritje të notave.
- Pagat e mësimeve të rriten në vazhdimësi për t’i motivuar për punë të vullnetshme shtesë, ndërsa për t’i larguar nga manipulimet me nxënës për interesa personale shtesë.
- Kultura bashkëpunuese mësimeve, prind dhe nxënës të jetë në nivelin e duhur e jo të familjarizohet ose të materializohet.
- Subjektet qendrave të kurseve private, në shkollë dhe jashtë, nuk duhet t’i nxisin mësimeve e punësuar në shkolla të punojnë te ata për ta zhvilluar biznesin privat, por duhet të punësojnë mësimeve tjerë, që janë të papunësuar.
- Fakultetet e Shkencave Natyrore duhet t’i kushtojnë kujdes lëndës së Etikës.
- Mësimeve duhet të ndjekin trajnim për vlerësimin profesional, etik dhe objektiv.

Conflict of interest declaration

I declare that I have worked on this paper myself to reflect the reasons for the increase in the unethical and objective evaluation of student achievements in primary schools in the last decade, since the criterion for enrollment in secondary school was set in our country to be “excellent success”. This paper focused on achieving several objectives:

- The first objective focused on reflecting the attitude of teachers towards the unethical and objective evaluation of student achievements by equalizing grades.
- The second objective focused on reflecting the attitude of parents towards the unethical and objective evaluation of student achievements by equalizing grades.
- The third objective focused on reflecting the attitude of students towards the unethical and objective evaluation of student achievements by equalizing grades.
- The fourth objective of this paper was to conduct a survey with the same students using Questionnaire-D, to discover the reason for students' engagement in extracurricular activities in different courses.

Deklarata e konfliktit të interes

Deklaroj e këtë punim e kam punuar vet për t’i pasqyruar arsyet e rritjes së vlerësimi joetikë dhe joobjektiv së të arriturave të nxënësve në shkolla fillore në dekadën e fundit, prej kur në shtetin tonë u vendos kriteri për regjistrim në shkollë të mesme të jetë “suksesi i shkëlqyeshëm”. Ky punim u përqendrua në arritjen e disa objektivave:

- Objektiva e parë u përqendrua në pasqyrimin e e qëndrimit të mësimdhënësve për vlerësimin joetik dhe joobjektiv së të arriturave të nxënësve me barazimin e notave.
- Objektiva e dytë u përqendrua në pasqyrimin e e qëndrimit të prindërve për vlerësimin joetik dhe joobjektiv të të arriturave të nxënësve me barazimin e notave.
- Objektiva e tretë u përqendrua në pasqyrimin e qëndrimit të nxënësve për vlerësimin joetik dhe joobjektiv dhe barazimin e notave.
- Objektiva e katërt e i këtij punimi u nxit për të zhvilluar edhe një anketim me nxënësit njëjtë me ndihmën e Pyetësorit- D, për të zbuluar arsyen e angazhimit të nxënësve në aktivitete jashtëmësimore në kurse të ndryshme.

About the author

Dr. Merita Banjica currently works in a primary school, but she never shied away from scientific research and participation in scientific conferences. She researches and writes about leadership and management in education, teaching and language. She is also a translator of the Macedonian language into the Albanian language.

Për autorin

Dr. Merita Banjica aktualisht punon në një shkollë fillore, por ajo asnjëherë nuk largua hulumtimeve shkencore dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore. Ajo hulumton dhe shkruan për udhëheqjen dhe menaxhimin në arsim, mësimdhënien dhe për gjuhën. Gjithashtu është edhe përkthyes e gjuhës maqedonase në gjuhën shqipe.

Merita i ka të publikuara disa libra dhe artikuj shkencore në: Academia.edu, Globe.Edit, Knowledge: International Journal, Interligua, Centrum etj.

<https://ikm.mk/ojs/index.php/kij/article/view/169>

<https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=954395>

https://www.researchgate.net/publication/310804338_Linguistic_Diversity_And_The_Advances

https://www.researchgate.net/publication/310804338_Linguistic_Diversity_And_The_Advances

<https://journals.indexcopernicus.com/api/file/viewByFileId/1145360>

<https://my.globeedit.com/catalog/index?layout=glutifag&page=189>

<https://www.walmart.com/ip/Q-ndrimi-i-drejtor-ve-ndaj-ndryshimeve-n-shkoll-2009-2010-Paperback-9786200619686/347765382>

<https://botimpex.com/index.php?p=liber&l=1914>

<https://konferenca.unishk.edu.al/icrae2014/cd/pdfdoc/578.pdf>

[https://library.carolinau.edu/eds?query=%22Creative%20thinking%22&type=DE&ff\[\]=Language:macedonian](https://library.carolinau.edu/eds?query=%22Creative%20thinking%22&type=DE&ff[]=Language:macedonian)

<https://journals.indexcopernicus.com/api/file/viewByFileId/1145360>

<https://centrum.mk/wp-content/uploads/2023/12/PJESA-16.pdf>

https://www.researchgate.net/publication/384216777_ISOGLOSAT_E_VARIETETEVE_GJUHESORE_NE_TE_FOLMEN_E_GOSTIVARIT_ISOGLOSSES_OF_LANGUAGE_VARIETIES_IN_THE_SPEECH_OF_GOSTIVARI

Referenca

- 1) Charls, Temple dhe të tjerët (2006) Strategji të mësimdhënies dhe të nxënimit për klasat mendimtare, botim i projektit "Zhvillimi i të menduarit kritik gjatë të lexuarit dhe të shkruarit", Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë dhe Qendra për Arsim të Kosovës, Prishtinë
- 2) Jeff, Zwiars (2005) Zhvillimi i shprehive të të menduarit në shkollë në klasat 6-12, Manuel veprimtarish mësimore për intelegjencat e shumëfishta, Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë dhe Qendra për Arsim të Kosovës, Prishtinë.
- 3) Murati, Xeladin (2024) Arsimi zbërthen në lëvizje (Pedagogjia gnesologjike), Litera Academy, Tetovë.
- 4) Murati, Xeladin (2024) Fuqia transformuese e arsimit, Litera Group, Shkup.
- 5) Murati, Xeladin (2024) Hyrje në Andragogji, Litera Academy, Tetovë.
- 6) Murati, Xeladin (2024) Për metodologjinë e kërkimit dhe kërkimet në arsim, Litera Group, Shkup.
- 7) Musai, Bardhyl (2014) Metodologji e mësimdhënies-Arti dhe shkenca për të përgatitur nxënës të suksesshëm, botimi i dytë nga Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë.
- 8) Mustafa, Avzi (2002) Didaktika e gjuhës shqipe dhe leximit letrar, Shtëpia botuese Logos, Shkup.
- 9) Woolfolk, Anita (2011) Psikologji edukimi-Universiteti Shtetëror i Ohajës, Botuar nga Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë
- 10) Zajazi, Tahir (2003) Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies-Didaktika, Vinsent Graphic, Shkup.

Burime nga doracakë për vlerësimin e të arriturrave të nxënësve

- 1) Zbatimi i standardeve të vlerësimit të nxënësve (*Material për stërvitje 1*) USAID from the American People dhe AED (Academy for Educational Development) dhe Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) 2008 –Shkup. Ky doracak është finacuar nga populli amerikan përmes Agjencisë së SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar-USAID Maqedoni, në kuadër të Projektit të Arsimit Fillor, Komponenti Përparimi i Vlerësimit të nxënësve, të cilën e aplikon Akademia për Zhvillimin e Arsimit (AZHA) në partneritet me Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ).
- 2) Zbatimi i standardeve të vlerësimit të nxënësve (*Prezantime dhe materiale punuese për stërvitje 1*) USAID from the American People dhe AED (Academy for Educational Development) dhe Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar

- (QMEQ) 2008 –Shkup. Ky doracak është financuar nga populli amerikan përmes Agjencisë së SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar-USAID Maqedoni, në kuadër të Projektit të Arsimit Fillor, Komponenti Përparimi i Vlerësimit të nxënësve, të cilën e aplikon Akademia për Zhvillimin e Arsimit (AZHA) në partneritet me Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ).
- 3) Tomas Gjerard dhe Karl Kiçing (2007) Avancimi i Vlerësimit në shkolla, Agjensioni për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID), Shkup, Maqedoni. Ky publikim është prodhuar për rishikim nga ana e Agjensioni për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Është përgatitur nga Tomas Gjerard dhe Karl Kiçing në bashkëpunim me: USAID projektin për Aktivitete për arsim të mesëm, USAID projektin për Zhvillim Njerëzor dhe Institucional, from the American People, Institutit Amerikan për Hulumtim (AIR) dhe Organizata Ndërkombëtare për Lexim (IRA).
 - 4) Përse nevojitet kodeksi etik i Vlerësimit –finasuar nga populli amerikan përmes Agjencisë së SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar-USAID Maqedoni, në kuadër të Projektit të arsimit fillor, komponenti Përparimi i Vlerësimit të nxënësve, të cilin e aplikon Akademia për Zhvillim të Arsimit (AZHA) në partneritet me Qendrën Maqedonase për Edukim Qytetar.
 - 5) Notim për mësim në shekullin 21-përmbledhje e shembujve nga praktika (2010). Doracaku është financuar nga populli amerikan, përmes Agjencisë së SHBA-ve për zhvillim ndërkombëtar – USAID Maqedoni, në kuadër të Projektit për arsim fillor, komponenti Avancimi i Vlerësimit të nxënësve, implementuar nga Akademia për Zhvillim të Arsimit (AED), në partneritet me Qendrën Maqedonase për Edukim Qytetar (MCGO). Qëndrimet e autorëve të prezantuara në këtë doracak nuk i shprehin qëndrimet e Agjencisë së SHBA-ve për zhvillim ndërkombëtar e as të qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikan.
 - 6) Mësimdhënia dhe mësimi në shekullin 21 (2009) Doracak për arsimtarët e arsimit fillor-Projekt i arsimit fillor, Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID Maqedoni dhe Akademia për Zhvillim të Arsimit –AED Maqedoni, Shkup.
 - 7) Praktikum për mësimdhënie dhe mësimi në shekullin 21 (2010), Doracak për arsimtarët e arsimit fillor-Projekt i arsimit fillor, Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID Maqedoni dhe Akademia për Zhvillim të Arsimit –AED Maqedoni, Shkup.
 - 8) Kodeksi etik për testimin e diturive të nxënësve– Qendra Maqedonase për Arsimim Qytetar - USAID From The American People-Primary Education Project, 2009, Shkup, R e Maqedonisë

Burime nga internet

- 1) Standardet e vlerësimit të nxënësve në shkollën fillore, parë më 09.01.2023 <https://trekendeshididaktik.files.wordpress.com/2014/11/standardet.pdf>
- 2) Vlerësimi i nxënësve, parë më 09.01.2023. https://sq.wikipedia.org/wiki/Vler%C3%ABsimi_i_nx%C3%ABn%C3%ABsve

- 3) Etika në sistemin arsimor shqiptar parë më 09.01.2023. <https://epale.ec.europa.eu/sites/default/files/raport-studimin-etika-ne-sistemin-arsimor-ne-shqiperi.pdf>
- 4) Etika në sistemin arsimor shqiptar parë më 09.03.2025. <https://acer.org/al/wp-content/uploads/2023/04/Raport-Studimi-Etika-ne-Sistemin-Arsimor-ne-Shqiperi.pdf>
- 5) Si vlerësimi dinamik formativ mund të përmirësojë të nxënësit e nxënësve (derrick meador) parë më 09.01.2023. <https://sq.eferrit.com/si-vleresimi-dinamik-formativ-mund-te-permiresoje-te-nxenit-e-nxenesve/>
- 6) Indikatorë për kualitetin e punës së shkollave (2019), Republika e Maqedonisë së Veriut Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Shkup, parë më 12.10.2023 në: <https://dip.gov.mk/wp-content/uploads/2021/04/priracnik-ikru-alb.pdf>
- 7) Vera Mentero dhe të tjerët (2021) Assessment Conceptions and Practices: Prespectives of Primary Schoools Teachers anda Stdudents, 07.April.2021 parë më 12.01.2023 në: <https://www.frontiersin.org/articles/10.3389/feduc.2021.631185/full>
- 8) Melaku & Wudu Melse (2022) Primary school teachers' conceptions and practices of assessment and their relationships, *Cogent Education*, 20 Jun 2022, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/2331186X.2022.2090185>
- 9) Muianga Ferizado (2023) English language Teacher's cenceptions of assesment parë më 28.02. 2023 në: <https://www.frontiersin.org/articles/10.3389/feduc.2022.972005/full#ref43>
- 10) Therese N. Hopfenbeck (2018). Classrrom assessment , pedagogy and learning – twenty years after Black and Wiliam 1998 parë më 28.02.2023 në: <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/0969594X.2018.1553695>
- 11) Banjica,M. (2014) Formative assessment diagnostifician achievement of the pupil the reflektion of techers work, parë më 12.01.2023 në: <https://independent.academia.edu/MeritaBanjica>
https://www.academia.edu/68709270/Formative_Assessment_Diagnostician_Achievements_of_the_Pupiand_the_Reflection_of_Teachers_Work
- 12) Assessment for Learning Formative Assessment pare më 14.01.2023 në: <https://www.oecd.org/site/educeri21st/40600533.pdf>
- 13) Udhëzime për përgatitjen e kodeve të etikës në punën institucional parë më 16.01.2023 në: <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2022/02/Kodi-etik-AL.pdf>
Etika parë më 16.01.2023 në: <https://sq.wikipedia.org/wiki/Etika>
- 14) Kiril Temkov (2010). Etika Për Klasën VI parë më 16.01.2023 në: https://e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Etika_7_alb.pdf
- 15) Përparimi i arritjeve të nxënësve(2008) USAID dhe ADE dhe QMEQ parë më 17.01.2023 në: https://www.mcgo.org.mk/pub/Ocenuvanje_na_napredokot_i_postiganjata_na_ucenicite_ALB.pdf

- 16) Notim për mësim në shekullin 21-përmbledhje e shembujve nga praktika(2010)
parë më 17.01.2023 në:
https://www.mcgo.org.mk/pub/Ocenuvanje_za_ucenje_vo_21_vek_ALB.pdf
- 17) Udhëzues i Kodit të Etikës për vlerësimin e nxënësve parë më 15.01.2025 :
<https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ua-kodi-i-etik.pdf>
Zbatimi i standardeve të notimit të nxënësve parë më 05.03.2025 në:
https://www.mcgo.org.mk/pub/Primena_na_standardi_za_ocenuvanje_ALB.pdf
- 18) Kodi i Etikës për vlerësimin e nxënësve parë më 11.03.2025 në: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ua-kodi-i-etik.pdf>
- 19) Ligji për arsim fillor. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/2019 dhe 229/2020) parë më 02.05.2024 në:
https://www.google.com/search?q=Ligji+p%C3%ABr+arsim+fillor+n%C3%AB+R+MV&sca_esv=158adc10c3c9ceae&rlz=1C1GGRV_enMK963MK963&sxsrf=ACQVn09X9woMC5-

Creative Commons licensing terms

Author(s) will retain the copyright of their published articles agreeing that a Creative Commons Attribution 4.0 International License (CC BY 4.0) terms will be applied to their work. Under the terms of this license, no permission is required from the author(s) or publisher for members of the community to copy, distribute, transmit or adapt the article content, providing a proper, prominent and unambiguous attribution to the authors in a manner that makes clear that the materials are being reused under permission of a Creative Commons License. Views, opinions, and conclusions expressed in this research article are views, opinions, and conclusions of the author(s). Open Access Publishing Group and European Journal of Foreign Language Teaching shall not be responsible or answerable for any loss, damage, or liability caused in relation to/arising out of conflicts of interest, copyright violations, and inappropriate or inaccurate use of any kind content related or integrated into the research work. All the published works are meeting the Open Access Publishing requirements and can be freely accessed, shared, modified, distributed, and used in educational, commercial, and non-commercial purposes under a [Creative Commons Attribution 4.0 International License \(CC BY 4.0\)](#).